

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Shtator 2022/ Nr. 9

**PELESHI PREZANTON SHEFIN E RI
TË SHTABIT TË FA-së, GJENERAL
BRIGADE ARBEN KINGJIN**



**Ministri Peleshi: Gjeneral Kingji vjen në këtë
detyrë nga një karrierë 28-vjeçare e suksesshme
dhe sfiduese e ushtarakut shqiptar**

Përmbajtja

Numri 9

VIZITA NË KOSOVË

- 8** Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj: Së bashku fituam luftën, bashkë duhet të luftojmë për të ruajtur paqen

INCIDENTI NË UZINËN E GRAMSHIT

- 14** Ministri Peleshi: Ngjarje të tilla duhen trajtuar me përgjegjshmëri

CEREMONIA

- 19** Arben Skënderaj emërohet drejtor i QKMBMMFA-së

GJEOPOLITIKË

- 27** Spiunazhi, tradhtia dhe shoqëritë demokratike

DOSSIER

- 30** Ded Gjon Luli Dedvukaj, strateg i shquar i kombit shqiptar

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 SHEFI I RI I SHP TË FA

Ministri Peleshi: Gjeneral Kingji vjen në këtë detyrë nga një karrierë 28-vjeçare e suksesshme dhe sfiduese e ushtarakut shqiptar

Gjeneral brigade Arben Kingji mori detyrën si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shefi i ri i FA-së u prezantua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi...



10 LUIZA GEGA SHPALLET KAMPIONE E EUROPËS

Kryeministri Rama: Luiza i dhuroi vendit imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve

Luiza Gega nuk di të ndalet, duke shkruar historinë për sportin shqiptar. Atletja, përfaqësuese e Forcave të Armatosura ka bërë një paraqitje...



16 FORCA TOKËSORE

22 vite histori, përkushtim, bashkëpunim

Forca Tokësore është njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura. Forca Tokësore u krijua më datë 29 gusht 2000, duke përfshirë në radhët e saj ...



23 Sociale

"Çfarë bën ti për Shqipërinë që Shqipëria të bëjë për ty?"

Sipas këtij parimi vlerësohen heronj, politikanë, shkrimtarë dhe artistë, qysh me të madhin De Rada, me "Milosaon" magji, Naim Frashërin...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 9/ 2022

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





PELESHI PREZANTON SHEFIN E RI TË SHTABIT TË FA-së,
GJENERAL BRIGADE ARBEN KINGJIN

Ministri Peleshi: Gjeneral Kingji vjen në këtë detyrë nga një karrierë 28-vjeçare e suksesshme dhe sfiduese e ushtarakut shqiptar

Gjeneral brigade Arben Kingji mori detyrën si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Shefi i ri i FA-së u prezantua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në një ceremoni zyrtare, ku morën pjesë gjeneralë, drejtues civilë, ushtarakë, atashe të mbrojtjes etj.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes theksoi se gjeneral Kingji vjen në këtë detyrë si një produkt i natyrshëm i karrierës së suksesshme dhe sfiduese të një ushtaraku shqiptar, pas një pune të gjatë 28-vjeçare.



Z. Peleshi tha se gjeneral Kingji e merr detyrën në një kohë kur siguria dhe paqja janë realisht të rrezikuara dhe kërcënuara, për shkak të agresionit rus në Ukrainë: "Përballja me sfidat që ofron mjedisi i ri i sigurisë parashtrojnë domosdoshmërinë për të pasur një forcë të armatosur të motivuar, të mirë pajisur dhe mirë trajnuar, të ndërveprueshme, e cila duhet të jetë e gatshme që të realizojë me sukses misionin e saj kushtetues. Tashmë, Forcat e Armatosura janë duke u pajisur me armatim, teknike dhe sisteme moderne dhe të ndërveprueshme. Angazhimi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i qeverisë është vijimi i rritjes së buxhetit të mbrojtjes me synim përmbushjen e objektivave të NATO-s brenda afateve kohore të përcaktuara, me prioritet: Grup - batalionin e Këmbësorisë së Lehtë, rritjen e flotës së helikopterëve, përmirësimin e kapaciteteve të Flotës Detare, si dhe jo më pak nga rëndësia, vijimin e transformimit të sistemit të edukimit ushtarak", - deklaroi gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes tha se sa i përket sfidave të brendshme fokusi do të përqendrohet në konsolidimin e kapaciteteve në përgjigje të emergjencave civile, si edhe kapaciteteve të veçanta si ato të kibernetikë, xhenierë dhe EOD. Teksa i uroi suksese në detyrën e re, gjeneral Kingjit, ministri Peleshi tha se FA-të do të kenë mbështetjen e përhershme të autoriteteve.

Më herët gjeneral brigade Arben Kingji u betua para presidentit të Republikës sh.t. z. Bajram Begaj me dorën mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ai u dekretua SHSHPFARSH nga presidenti i Republikës, pas propozimit të ministrit të Mbrojtjes dhe kryeministrit. Më parë ai mbante detyrën e komandantit të Forcës Tokësore.



Presidenti i Republikës dekreton emërimin e gjeneral brigade Arben Kingjit, shef të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij z. Bajram Begaj, ka dekretuar sot emërimin e gjeneral brigade Arben Kingjit, shef të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH.

Dekreti si më poshtë vijon:

"Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 169, pika 3, të Kushtetutës, të nenit 9, pika 3, shkronja "b", të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë me nr. 4460/1 prot., datë 29.07.2022,

D e k r e t o j N e n i 1

Gjeneral brigade Arben Voke Kingji, emërohet shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

N e n i 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. i Dekretit 13840
Tiranë, më 02.08.2022
Presidenti i Republikës
Bajram Begaj**

Fjala e gjeneral brigade Arben Kingjit, me rastin e marrjes së detyrës si shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH

SHSHPFJA Arben Kingji: E sotmja për mua është një ditë krenarie, nderi e përgjegjshmërie

Krenar që pas 37 vitesh kontribut në Forcat e Armatosura m'u besua detyra fisnike e plot sfida e përgjegjësi, veçanërisht në kohët që po jetojmë, ajo e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Mirënjohje për të gjithë ata që besuan tek unë që nga ushtari i parë, tek kolegët, komandantët e drejtuesit përgjatë këtyre tre dekadave karrierë.

I nderuar të jem në krye të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave nën uniformë, të cilët me ndershmëri dhe përkushtim i qëndrojnë besnikë betimit që kanë bërë.

Mirënjohje për vlerësimin, ministrit të Mbrojtjes z. Peleshi, kryeministrit Rama dhe presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Begaj.

Shpreh mirënjohjen për presidentin e RSH, z. Bajram Begaj, për punën e shkëlqyer që la pas si ish - shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, e bazuar në një vizion me ide të qarta e të prekshme, i orientuar nga ndjenja e lartë e përgjegjësisë së kryerjes së detyrës.

E falënderoj për besimin e treguar për dekretimin tim në këtë detyrë të rëndësishme dhe premtoj që do të çoj më përpara me vendime e veprime konkrete, në përmbushje të objektivave të vendosura për transformimin e FARSH në një ushtri sa më të kompletuar dhe e aftë që t'i përgjigjet kërkesave kombëtare dhe angazhimeve që rrjedhin nga aleanca.

Z. Ministër i Mbrojtjes, gjej rastin t'ju shprehim në radhë të parë si Forcë e Armatosur, falënderimet dhe mirënjohjen për rolin e rëndësishëm që keni kryer në angazhimin dhe mbështetjen për modernizimin e kapaciteteve operacionale, si dhe projektet e tjera të rëndësishme në përmirësim të infrastrukturës akomoduese dhe stërvitore.

Faleminderit për mbështetjen dhe ju siguroj me besimin e plotë, që përkushtimi im dhe i gjithë ushtrisë shqiptare do të jetë maksimal dhe nuk do t'ju zhgënjimë në detyrat që do na ngarkohen.

I përgjegjshëm për sfidat, vështirësitë dhe detyrat, që do të përballim në pozicionin që do të mbaj prej ditës së sotme. Nuk do të jetë e lehtë, por jam i sigurt që besimi, bashkëpunimi dhe vizioni për të ardhmen që të gjithë ne, në Forcën e Armatosur ndajmë, do të jenë udhërrëfyesi i çdo dite time të punës.

Ky garnizon sot ka shumë kuptim për mua. Në shtator të vitit 1985, asokohe nxënës në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", nisa një rrugë të re. Familja ishte shtylla ime e fortë e besimit dhe e tillë ajo është dhe sot.

I përulëm me respekt prindërve të mi, bashkëshortes, vajzës e djalit për çdo sakrificë e durim për ditët e javët larg atyre, për mbështetjen në çdo situatë e për dashurinë e dhënë për t'u bërë ai që jam sot.

Familjes së madhe të Forcave të Armatosura gjithashtu i detyrohem shumë ndaj dhe motivi i punës time, si në çdo detyrë që më është besuar, do të jetë dinjiteti i çdo ushtaraku të Forcave të Armatosura.

Askush dhe asgjë nuk do të mund të cenojë dinjitetin e çdo gruaje e burri, djali e vajze në uniformë. Ky është premtimi im, veçanërisht për çdo të ri që i është bashkuar rishtazi Akademisë së FA-së dhe çdo strukture tjetër përbërëse të FA-së, sipas modelit të disiplinës e dashurisë për Shqipërinë.

Prej 13 vitesh anëtar i NATO-s, prej disa muajsh në tryezën vendimmarrëse të Këshillit të Sigurimit e së fundmi me negociata të çelura për anëtarësim në Bashkimin Europian, vendi ynë, i vogël gjeografikisht, por me peshë të madhe në arenën ndërkombëtare, ka dëshmuar se di të rreshtohet denjësisht për krahu vendeve partnere dhe aleate.



Forcat e Armatosura do të vazhdojnë të zhvillohen e integrohen, me qëllim kryerjen me profesionalizëm të angazhimeve dhe kontributit për paqen dhe sigurinë, përmes pjesëmarrjes në misione dhe operacione në kuadër të Aleancës, Bashkimit European, Kombeve të Bashkuara dhe iniciativave rajonale.

Kontributi ynë në forcat shumëkombëshe në Letoni, në KFOR dhe së shpejti pjesë e Brigadës Shumëkombëshe të Forcës së Përparuar të NATO-s, janë prova që ne shihemi sot si një vend serioz, me një ushtri profesionale, me kapacitetet e nevojshme si kontribuuese për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, si një faktor stabiliteti, dhe nxitës i bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor.

Gjej rastin të përgëzoj dhe të siguroj aleatët tanë të rëndësishëm strategjikë dhe vendet partnere, se bashkëpunimi si në kuadër të Aleancës ashtu dhe në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe, do të zënë vend të rëndësishëm në punën e tonë në angazhimet e përbashkëta ushtarake dhe gjeostrategjike.

Në kuadër të stabilitetit rajonal, FARSH-të do të jenë promotor i bashkëpunimit sa më konkret me Forcën e Sigurisë së Kosovës, realizimin e stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta, edukim dhe dhënien e ekspertizës më të mirë ushtarake, si dhe mbështetës të fortë për pjesëmarrjen në iniciativa rajonale dhe globale në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Me rastin e 100 - vjetorit të marrëdhënieve SHBA - Shqipëri, gjej rastin të shpreh mirënjohjen Departamentit Amerikan të Shtetit për ndihmën dhe mbështetjen e paçmuar dhe të vazhdueshme që i kanë dhënë ushtrisë sonë në modernizim, trajnim, stërvitje, në ristrukturimin e forcave të armatosura, si dhe nëpërmjet prezencës së ekipeve këshilluese për njësitë e deklaruara në NATO si kapacitete kombëtare. Tek ne do të gjeni gjithmonë një vend mik e aleat të palëkundur.

Agresioni rus ndaj Ukrainës ka ndryshuar tërësisht mjedisin e sigurisë. Kërcënimet e vjetra dhe ato të reja, parashtrajnë domosdoshmërinë për të pasur një forcë të armatosur të motivuar, të mirë pajisur dhe mirë trajnuar, të ndërveprueshme, e cila duhet të jetë e gatshme që të realizojë me sukses misionin e saj kushtetues.

Me rritjen e Buxhetit të Mbrojtjes, Forcat e Armatosura do të synojnë përmbytjen e objektivave të NATO-s brenda afateve kohore të përcaktuara, me prioritet Grup - batalionin e Këmbësorisë së Lehtë i cili do të vlerësohet nga NATO muajin e ardhshëm, përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore dhe Forcës Detare si dhe jo më pak nga rëndësia, transformimin e sistemit arsimor dhe të edukimit ushtarak.

Ndërsa, në përgjigje të sfidave të brendshme, fokusi do të përqendrohet në konsolidimin e kapaciteteve në përgjigje të emergjencave civile, si edhe kapaciteteve të veçanta si ato të kibernetikës, xheniere dhe EOD.

Forcat e Armatosura kanë nevojë të përmirësojnë dhe rrisin kapacitetet e tyre operacionale edhe për vitet që do vijjnë.

Kryefjala do të jetë motivimi, arsimimi, edukimi dhe përgatitja e personelit, përmirësimi i kushteve të jetesës, modernizimi dhe rritja e kapaciteteve të luftimit dhe mbështetjes me shërbime luftimi, si dhe angazhimi në misionet brenda dhe jashtë vendit.

Si shef i Shtabit të Përgjithshëm, unë do të shfrytëzoj autoritetin e pozicionit dhe mandatin që ju më jepni në orientimin dhe harmonizimin e përpjekjeve të përbashkëta, për t'iu përgjigjur sfidave dhe kërcënimeve të së ardhmes, në përmbytje të misionit kushtetues dhe detyrimeve në interes të Aleancës.

Ju siguroj se prioritet kryesor i punës time do të jetë zhvillimi dhe motivimi i personelit, modernizimi dhe rritja e kapaciteteve operacionale, si dhe përmirësimi i sistemit doktrinar në të gjitha nivelet dhe fushat.

Do të punoj për të materializuar përgjegjësinë tonë për të ecur dhe zhvilluar në drejtimin e duhur. Me përpjekje dhe qëllim të përbashkët, me pasion dhe përkushtim, ndershmëri dhe profesionalizëm të lartë, shpreh bindjen se do ta përmbyshim me sukses misionin ndaj historisë, popullit dhe vendit tonë!

Në fund të fjalës sime, dua të përsënder ushtarakët brenda e jashtë vendit, aktiv e në rezervë. Krahas vëmendjes së shtuar nga qeveria dua t'ju siguroj se do të jem zëri juaj për çdo detyrë e sakrificë të misionit kushtetues që do t'ju kërkohet dhe ngarkohet.



Kreu i ri i shtetit, vizitën e parë e zhvillon në Kosovë

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj: Së bashku fituam luftën, bashkë duhet të luftojmë për të ruajtur paqen

Vizitën e parë, kreu i shtetit shqiptar, presidenti i Republikës dhe njëkohësisht komandant i Forcave të Armatosura Bajram Begaj e zhvilloi në Kosovë, ku u prit nga krerët më të lartë të vendit.

Në takimin me presidenten Vjosa Osmani, presidenti Begaj do të shprehej.

Jam shumë i lumtur për ftesën Tuaj, Presidente Osmani!

Vij në shtëpi dhe në shtëpinë e shqiptarisë si bir e vëlla, mes bijve të kësaj toke krenare dhe vëllezërve të të njëjtit identitet, aty ku shtëpia është e mikut dhe Zotit.

E dashur Vjosa,

Faleminderit për pritjen e ngrohtë, vëllazërore si dhe bisedën që zhvilluam sot me shkëmbime idesh, pikëpamjesh, qëndrimesh dhe vizioni për dy vendet tona!

Jam i nderuar të jem në Prishtinë,

në vizitën time të parë si President, dhe kjo jo thjesht në respekt të traditës, por si një simbolikë e natyrshme, që mishëron lidhjen tonë të pandashme dhe të pandryshueshme e vulosur nga historia, gjuha jonë e përbashkët dhe heronjtë tanë ndër shekuj.

Dy dialekte dhe një gjuhë, dy Republika dhe një komb, kjo është harta jonë e përbashkët patriotike me destinacion Brukselin dhe bashkimin tonë në aleancën euroatlantike.

Së bashku fituam luftën, bashkë duhet të luftojmë për të ruajtur paqen. Ky është amaneti dhe trashëgimia solemne e Ismail Qemalit dhe Isa Boletinit; e Ibrahim Rugovës dhe Adem Jasharit; e çdo luftëtari të UÇK-së, e çdo kulm-kulle në çdo pëllëmbë të kësaj toke, që quhet Republika e Kosovës.

Ibrahim Rugova ishte një udhëheqës vizionar e qëndrestar dhe

themelues i Pavarësisë së Kosovës. Vizioni i tij është shembull frymëzimi për të gjithë politikanët, në Kosovë dhe në Shqipëri.

UÇK-ja përbën një faqe të ndritur të historisë sonë të përbashkët, që bën krenar çdo shqiptar.

Asnjë raport i trilluar, që tenton të njollojë gjakun dhe vetëflijin e shqiptarëve në mbrojtje të lirisë, flamurit dhe identitetit kombëtar, nuk do të arrijë kurrë të zbehë këtë trashëgimi të lavdishme.

Ndamë sot të njëjtin qëndrim me Presidenten Osmani se Kosova dhe Shqipëria, jo vetëm gëzojnë këtë lidhje të pazgjidhshme vëllazërore e strategjike, por edhe të njëjtin vizion dhe aspirata, të ardhmen në Bashkimin Europian dhe në NATO. Reformat integruese, për forcimin dhe demokratizimin e institucioneve, ndërtimin e shtetit ligjor, konsolidimin e ekonomisë së tregut, nga

njëra anë dhe një perspektivë e besueshme europiane për vendet e Ballkanit Perëndimor, nga ana tjetër, mbeten thelbësore për të siguruar stabilitetin rajonal, për të mbështetur mirëqenien dhe paqen në rajonin tonë.

Hapja e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian është një arritje e shumëpritur dhe një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët në Shqipëri, por edhe për Kosovën dhe gjithë rajonin.

Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është një premtim i vonuar dhe një e drejtë që ata duhet ta gëzojnë, si të gjithë qytetarët e tjerë të rajonit, për të cilën unë e sigurova Presidenten Osmani se Shqipëria do të vijojë mbështetjen e saj për përmbylljen me lajm pozitiv, sa më parë të jetë e mundur.

Shqipëria mbështet fuqimisht anëtarësimin e Kosovës në NATO dhe vlerëson se NATO mbetet një garant i paqes në rajon dhe aleat strategjik i Kosovës dhe Shqipërisë.

Ne mbështesim anëtarësimin e Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe vlerësojmë se, aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Europës ishte vendimi i duhur, sigurova Presidenten Osmani se, gjatë mandatit në Këshillin e Sigurimit dhe si anëtare e OKB-së, Shqipëria do të jetë zëdhënëse e interesave të Kosovës, përforcuese e zërit të saj, në promovimin e shtetit të pavarur të Kosovës, pathyeshmërinë e këtij fakti, njohjet e reja dhe rrugëtimin e saj euroatlantik.

Lufta në Ukrainë na tregon edhe një herë se paqja është delikate dhe si asnjëherë më parë bota përballlet me kërcënime të reja. Siguria kombëtare, pavarësia energjetike, siguria ushqimore, pandemitë, siguria kibernetike, rezervat ujore etj., janë fusha me rëndësi prioritare dhe që më shumë se kurrë kërkojnë bashkëpunim të shtuar. Përsëritës maturinë e shtetit të Kosovës në përbalimin e krizës së 31 korrikut dhe mbështes plotësisht të drejtën e saj legjitime, për shtrirjen e autoritetit dhe vendosjen e sundimit të ligjit në veri të vendit, në bashkëpunim me partnerët tanë SHBA-në dhe BE-në.

Vlerësoj qëndrimin e Presidentes dhe qeverisë së Kosovës në vazhdimin e dialogut me Serbinë, si e vetmja mënyrë që të bëhet e qartë, se realiteti i Kosovës së pavarur është i pakthyeshëm dhe i pandryshueshëm.

Formula e zgjidhjes së dialogut

Serbi-Kosovë, e shprehur nga Presidenti Biden, si "marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve, e fokusuar në njohjen reciproke", apo qëndrimi i ripërsëritur i Kancelarit Gjerman Scholz se, njohja e Pavarësisë së Kosovës nga Serbia është kusht për anëtarësimin e Serbisë në BE – janë inkurajuese në përpjekjet tona, që rezultati përfundimtar të jetë një Marrëveshje e detyrueshme ligjore, që përcakton qartësisht njohjen e ndërsjellë, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës.

Kosova dhe Shqipëria janë dhe duhet të mbeten faktorë stabiliteti në rajon dhe vende kontribuuese të rëndësishme, për sigurinë në Ballkanin Perëndimor.

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i politikave dhe veprimeve të të gjitha institucioneve tona, duhet të jetë një objektivi i qëndrueshëm dhe parësor,



pasi kështu krijojmë të gjitha premisat, që faktori shqiptar të konsolidohet si faktor strategjik dhe faktor stabiliteti në rajon.

Vlerësuam se bashkëpunimi i shkëlqyer midis shteteve, qeverive dhe institucioneve tona, në kuadër të mbledhjeve të përbashkëta, bashkëpunimit ndërparlamentar, apo në kuadër më të gjerë ndërinstitutional, duhet të vijohet me punë intensive dhe të matshme për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve.

Të dy vendet duhet të vijojnë përpjekjet për të shfrytëzuar maksimalisht potencialet tona ekonomike.

Hapat e ndërmarrja tashmë, në lehtësimin e qarkullimit ndërkufitar për njerëzit, mallrat, shërbimet dhe kapitalin (si heqja e kontroleve kufitare për periudhën e verës, marrë-

veshja për qëndrimin e përkohshëm 5-vjeçar), apo projektet për ndërtimin e portit në Porto-Romano, Portit të Thatë në Prishtinë dhe lidhja e tyre me hekurudhën Durrës-Tiranë, janë hapat e duhur në drejtimin e duhur si investime prioritare, që jo vetëm do të forcojnë pozitat strategjike të dy vendeve tona në rajon, por edhe do t'i japin një impuls të ri e të nevojshëm bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve.

Në këtë kontekst, ne duhet të përfitojmë nga proceset dhe mekanizmat integruese evropiane apo rajonale, për të materializuar projektet tona të përbashkëta.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit dypalësh, por që kërkon kultivimin e vazhdueshëm nga të gjithë ne, është ai në fushën e arsimit dhe kulturës.

Projekti madhor mbarëkombëtar për hartimin e Enciklopedisë Shqiptare, do të përbëjë një gur kilometrik në promovimin ndërkombëtar të

identitetit kombëtar, të gjuhës, kulturës, trashëgimisë dhe historisë sonë kombëtare.

Vetëm një qasje përbashkuese, e mbështetur në politika të mirë-planifikuara e afatgjata, do të mundësojë që brezat e rinj shqiptarë, kudo ku ndodhen: në Shqipëri, Kosovë, rajon, diasporë e kudo tjetër, të rriten dhe arsimohen me vetëdijen e pa ngatërrueshme se i përkasin të njëjtit trugu kombëtar.

Përfundoj, duke theksuar se për vendimmarrje jetike në procese historike dhe të një rëndësie mbarë shqiptare, ne duhet të jemi të gjithë bashkë dhe të ecim përpara me ertësi e maturi, në mbrojtje të interesave tona, të qytetarëve tanë dhe në mbrojtje të paqes në rajon.

Faleminderit!

LUIZA GEGA
SHPALLET KAMPIONE
E EUROPËS NË GARËN E
3000 METRAVE
ME PENGESA



Kryeministri Rama: LUIZA I DHUROI VENDIT IMAZHIN E NJË SHQIPËRIE që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve



9.11.31, që u bë rekordi i ri i Kampionatit European, duke thyer me 6 sekonda atë të vendosur në vitin 2010 nga rusja Zaripova.

Kryeministri Edi Rama, në pritjen e organizuar për nder të atletes tha:

"Luiza i dhuroi vendit imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve, nëse e shohim të gjithë rrugëtimin dhe vrapimin e Luizës deri kur ka zbritur në pistë për ato më pak se 10 minuta që tanimë i përkasin historisë, ato janë hapa të pafundmë sfilite, gjaku, lotësh

u thanë shumë fjalë, por prapë kjo arritje të lë pa fjalë, por të paktën me të gjithë ceremonialin që ofron shteti", - iu drejtua Rama, kampiones së Europës në atletikë. "Sipërmarrja e saj është marramendëse, kur flasim dhe mendojmë që çfarë i dhuroi Luiza Shqipërisë, imazhin e një Shqipërie që ia del me kokën lart mes të gjithë të tjerëve. Është e pamundur të mos e imagjinojmë se çfarë do të thotë kjo dhe është e pamundur të mos e shohim diferencën mes këtyre 4 fjalëve kaq të thjeshta dhe kaq të rënda dhe 400 milionë fjalëve

Luiza Gega nuk di të ndalet, duke shkruar historinë për sportin shqiptar. Atletja, përfaqësuese e Forcave të Armatosura ka bërë një paraqitje fantastike në finalen e 3000 metrave me pengesa, duke u shpallur Kampione e Europës në aktivitetin e zhvilluar në Mynih.

Kampionia shqiptare shkoi në finale me kohën më të mirë të regjistruar në fazën kualifikuese dhe ishte pretendente kryesore për të fituar këtë garë. Këtë e tregoi më së miri duke diktuar ritmin dhe duke marrë kryesimin që pas 100 metrave të parë, për të lënë pas të gjithë rivalet që kërkonin t'i rrëmbenin nga duart një medalje që e ndiqte prej shumë kohësh.

Askush nuk mbajti ritmin fantastik të Luiza Gegës në këtë garë dhe sportistja shqiptare ia doli të kalonte finishin e vetme me kohën



dhe djerse".

Më tej kryeministri iu drejtua kampiones: "Fort e admiruar kampione, tanimë edhe e Europës! Është një krenari dhe privilegj shumë i veçantë që të kemi sot këtu mes nesh në një përpjekje për të thënë faleminderit, jo doemos me të gjitha fjalët e nevojshme, edhe pse këtu

të tjera të kota që konsumohen përditë dhe që nuk prodhojnë asnjë gjë, gjak, sfilite, lot dhe djerse", - shtoi Rama. Kryeministri theksoi se: "fitorja madhështore me rekord të ri i Kampionatit European është edhe një dëshmi e vyer për të gjithë ne, sportistë e jo sportistë, të rinj apo më pak të rinj, për të gjithë brezat".

Gjeneral brigade Arben Kingji priti ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Tayyar Kağan Atay

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë, z. Tayyar Kağan Atay dhe atasheun ushtarak turk kolonel Muhamet Kelami Kablay.

Gjeneral brigade Kingji në fjalën e tij vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal, por edhe më tej, në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të përbashkëta dhe të NATO.

Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet gjerësisht dhe përfshin fushat e edukimit dhe trajnimit, shëndetësore, modernizimin dhe mbështetjen logjistike.

Gjeneral brigade Kingji theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e Edukimit dhe Trajnimit të ushtarakëve të FARSH në kurset dhe aka-



demitë turke, si një kontribut për zhvillimin e lidhshimit.

Ndërsa në lidhje me modernizimin e FA-ve, asistencën turke ka qenë domethënëse në rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe modernizimin me pajisje luftarake të ndërveprueshme të reparateve

të deklaruar në NATO.

Të dy bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve, sipas planeve të bashkëpunimit ushtarak bilateral si dhe atyre në kuadër të NATO-s dhe iniciativave rajonale.



SHSHPFPA, gjeneral brigade Arben Kingji, priti atasheun ushtarak të Gjermanisë, nënkolonelin Dirk Weber, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në Tiranë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim përshëndetës atasheun ushtarak të Gjermanisë, nënkolonelin Dirk Weber, në kuadër të përfundimit të mandatit të tij në Tiranë.

Gjeneral brigade Kingji, vlerësoi bashkëpunimin dhe marrëdhëniet ndërmjet Forcave të Armatosura të Gjermanisë dhe Shqipërisë, veçanërisht ato në fushën e arsimit dhe shprehur gatishmërinë për forcimin më tej të këtyre marrëdhënieve. Nga ana e tij, nënkolonelin Weber e falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, për mbështetjen e treguar gjatë kohës së qëndrimit të tij në detyrë, si dhe e siguroi atë se edhe pasardhësi i tij, nënkolonelin Hans-Peter Wamsler, do të vijojë punën për vijimin dhe forcimin e bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve.

Në përfundim të takimit, gjeneral brigade Kingji, duke i uruar suksese të mëtejshme, i akordoi nënkolonelin Weber "Certifikatë Mirënjohje", duke i uruar në të njëjtën kohë mirëseardhjen nënkolonelin Wamsler.



Komandanti i Forcës Ajrore priti në takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, priti në mjediset e Forcës Ajrore, në një takim kortezie, atasheun ushtarak të Kosovës nënkolonel Enver Hotin.

Qëllimi i aktivitetit ishte marrëveshja teknike ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës mbi trajnimin në fushën e aviacionit ushtarak të personelit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bazat ajrore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Nga ana e tij, nënkolonel Hoti siguroi se është i hapur për bashkëpunim të mëtejshëm midis palëve si dhe kërkoi që në kuadrin e bashkëpunimit të ketë shkëmbime vizitash për mbështetjen e FSK në procesin e zhvillimit të



kapaciteteve me eksperiencë dhe asistencë. Në përfundim të takimit, gjeneral brigade Pulaj falënderoi atasheun për vizitën e tij në Ko-

mandën e Forcës Ajrore dhe i uroi suksese të mëtejshme në detyrë, duke e siguruar se bashkëpunimi do të vazhdojë dhe në të ardhmen.



Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj priti në takim atasheun ushtarak të Gjermanisë

Komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Pulaj, priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Gjermanisë, nënkolonel Dirk Weber me rastin e përfundimit të detyrës. Gjeneral brigade Pulaj vlerësoi bashkëpunimin dhe marrëdhëniet ndërmjet dy Forcave Ajrore, veçanërisht ato në fushën e arsimimit dhe shprehu gatishmërinë për forcimin më tej të këtyre marrëdhënieve.

Nga ana e tij, nënkolonel Weber e falënderoi komandantin e Forcës Ajrore, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të treguar gjatë kohës së qëndrimit të tij në detyrë, si dhe e siguroi atë se pasardhësi i tij, nënkolonel Hans-Peter Wamsler, do të vijojë punën për forcimin e bashkëpunimit ushtarak si dhe do të ndjekë me vëmendje hapat për modernizimin e Bazës Ajrore Taktike të NATO-s, Kucovë.

Në përfundim të takimit, gjeneral brigade Pulaj i uroi suksese të mëtejshme nënkolonelit Weber dhe i uroi mirëseardhjen nënkolonelit Wamsler.

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj inspekton forcat në mision me ndërhyrje nga ajri

Helikopteri Cougar realizoi me sukses dy operacione me shkallë të lartë të vështirësisë.

Misioni i parë ishte në Mat, ku së bashku me forcat që ndodheshin në terren bënë të mundur shuarjen e zjarrit.

Misioni i dytë ishte në fshatin Shetaj, Durrës, i cili zgjati deri në orët e vona, falë ndërhyrjes nga ajri u bë e mundur shuarja e zjarrit.

U realizuan 10 orë e 40 minuta fluturim dhe janë hedhur 135 kova, 280 000 litra ujë.



Incidenti në uzinën e Gramshit

Ministri Peleshi:

Ngjarje të tilla duhen trajtuar me përgjegjshmëri

“Aldon dhe Ardiani paraqitën gjendje shëndetësore të mirë dhe shumë shpejt lanë ambientet e spitalit, ku patën ndihmën e menjëhershme të bluzave të bardha” - tha ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi vizitoi në QSUT dy efektivët e Forcave të Armatosura, që mbetën të lënduar gjatë incidentit në uzinën e Gramshit, ku tre shtetas të huaj, me pasaporta ruse dhe ukrainase tentuan të futeshin brenda ambienteve të uzinës.

“Aldon dhe Ardiani paraqitën gjendje shëndetësore të mirë dhe shumë shpejt lanë ambientet e spitalit, ku patën ndihmën e menjëhershme të bluzave të bardha” - tha ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes kërkoi që të bëhet durim deri në zbardhjen e plotë të ngjarjes, për të cilën po punojnë të gjitha strukturat, që nga Inteligjenca Ushtarake, Policia Ushtarake, Shërbimi Informativ Shtetëror, Policia e Shtetit dhe Antiterrori: “Tre shtetas të huaj u janë afruar ish-Uzinës Ushtarake të Gramshit. Them ish, sepse prej vitesh ajo uzinë nuk ka aktivitet. Një prej shtetasve të huaj ka kapërcyer rrethimin në mënyrë të paligjshme. Në këtë moment dy ushtarakët duke u ngritur në nivelin dhe përgjegjësinë e detyrës e kanë parandaluar. Shtetasi rus ka reaguar fizikisht, ka përdorur edhe një spray, që ka shkaktuar edhe lëndim, por, pavarësisht lëndimit, dy ushtarakët kanë njoftuar Policinë e Shtetit. Policia ka reaguar shumë

shpejt dhe ka bërë të mundur ndalimin dhe arrestimin e këtij shtetasi të huaj. Më pas, jo shumë larg nga uzina e Gramshit, janë ndaluar edhe dy shtetasit e tjerë, të cilët ndodheshin në një makinë. Padyshim që, e vendosur edhe në kontekstin e gjerë rajonal edhe në kontekstin politik, duhet vlerësuar dhe nuk mund të kalojë si një incident i zakonshëm, por ne nuk mund të nxitohejmë të nxjerrim konkluzione, por gjithsesi fakti që është reaguar dhunshëm nga këta shtetas të huaj na bën të jemi më të vëmendshëm për ta hetuar deri në fund. Janë shumë struktura që do të punojnë që nga Inteligjenca jonë ushtarake, Policia Ushtarake, Shërbimi Informativ Shtetëror, Policia e Shtetit, Antiterrori. Tani janë në pyetje dhe hetim që të tre shtetasit e huaj që, siç e thashë, mbajnë pasaporta ruse dhe ukrainase”, - deklaroi z. Peleshi.

Ministri theksoi se ngjarje të tilla duhen trajtuar me përgjegjshmëri: “Është jo normale që ngjarje të tilla t'i trajtojmë sikur të ishte politika lokale e ditës. Sepse këto janë kritike sidomos edhe deklarime sidomos të faktorëve politikë, deklarime të institucioneve shtetërore vërehen, analizohen, komentohen dhe mund të kthehen edhe në një problem shumë më të madh se vetë ngjarja”, - tha z. Peleshi.





Niset Kontingjenti i 2-të me mision pranë KFOR-it, në Kosovë

Peleshi: Rritja e forcave të armatosura të vendeve aleate në Misionin e KFOR-it, kontribut i madh i Aleancës për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor

Kontingjenti i 2-të me 30 efektivë nga Forca Tokësore, efektivë të Batalionit Komando (nga Regjimenti i Operacioneve Speciale - ROS) janë nisur për në Kosovë për të shërbyer si pjesë e misionit të KFOR. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në ceremoninë e përcjelljes, e vlerësoi këtë si një moment të veçantë për faktin se këta efektivë nisen në mision si përfaqësues të vendit në përpjekjet e Aleancës së NATO për t'i shërbyer sigurisë dhe paqes. "Republika e Shqipërisë në vijimësi ka dëshmuar se është jo vetëm faktor paqeje dhe stabiliteti rajonal e më gjerë, por edhe një aleat serioz, i cili merr përsipër dhe mban barrën e detyrimeve dhe në kuadër të mbrojtjes kolektive të Aleancës", - u shpreh gjatë fjalës së tij z. Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes theksoi mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë ndaj aspiratave të Kosovës, por vlerësoi edhe rritjen e pranisë së forcave të vendeve të Aleancës si pjesë e KFOR-it. "Mbështetja e Kosovës në aspiratat e saj kundrejt anëtarësimit në organizatat ndërkom-

bëtare, duke kontribuar në forcimin e paqes dhe sigurisë, inkurajon zhvillimin e rajonit dhe frenon zgjerimin e influencës të vendeve të tjera, që sfidojnë demokracinë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Sfidat tona të sigurisë mbeten të përbashkëta, të pandashme dhe të gjithanshme. Ato vijnë nga çdo drejtim dhe mund të cenojnë sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe më gjerë. Ministria e Mbrojtjes vlerëson dislokimin dhe rritjen e prezencës së forcave të



armatosura të vendeve aleate dhe partnere në Misionin e KFOR-it. Ky është një kontribut i madh i Aleancës për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Siç e nënvizoi dhe sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, pak ditë më parë, trupat e KFOR-it në Kosovë janë të gatshme dhe të vendosura për të ndjekur detyrën e tyre në përmbushje të misionit për të ruajtur një mjedis të sigurt në Kosovë dhe në rajon", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Peleshi vlerësoi edhe efektivët e Kontingjentit të Parë, të cilët sipas tij kanë treguar vlera dhe standarde të larta morale dhe, me profesionalizmin e tyre kanë fituar respektin dhe besimin e plotë të komandës të operacionit dhe efektivëve të tjerë të aleatëve të NATO-s.

30 trupat e Kontingjentit të 2-të nga Forca Tokësore, efektivë të Batalionit Komando (nga Regjimenti i Operacioneve Speciale - ROS) do të shërbejnë në zonën e Pejës, krah për krah me kolegët e tyre italianë dhe kroatë. Në ceremoninë e përcjelljes morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, oficerë, nënoficerë si dhe familjarë të efektivëve.



22 VITE HISTORI, përkushtim, BASHKËPUNIM, Forcë Tokësore

Forca Tokësore është njësi prioritare në strukturën e Forcave të Armatosura. Forca Tokësore u krijua më datë 29 gusht 2000, duke përfshirë në radhët e saj njësi dhe reparte me traditë me një veprimtari të pasur shumëvjeçare, të përhapura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2000 në përbërje të Forcës Tokësore ishin 5 divizione këmbësorie me rreth 55 brigada dhe 300 batalione të përhapur në 167 rajone të ndryshme të vendit. Gjatë reformimit të vazhdueshëm, Forca Tokësore pësoi ndryshime të reja. Në vitin 2006, suprimohet Forca Tokësore dhe krijohet Komanda e Forcës së Bashkuar.

Misioni

Mbrojtja e pavarësisë, sovranitetit, tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrja në operacione humanitare, luftarake, jo luftarake dhe ato të mbështetjes së paqes.

Detyra të veçanta

- Ruajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve për të siguruar nivel të lartë gatishmërie.
- Trajnim të vazhdueshëm dhe të mirë për aktivizimet në detyrat që mund t'i jepen.
- Ndhim komunitetin në rast emergjencash humanitare. Mbështet

kërkimet tokësore dhe operacionet e shpëtimit.

- Bashkëpunon me institucione të tjera kombëtare në ndalimin e trafikimit ilegal të kontrabandës, personave, armëve konvencionale, në Shqipëri.

- Trajnon, stërvit dhe merr pjesë me trupa në misionet e mbështetjes së paqes në kuadër të NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Në kuadër të transformimit të vazhdueshëm të Forcave të Armatosura, bazuar edhe në konceptin e një ushtrie sa më të vogël në numër dhe sa më operacionale e profesionale, më 9 dhjetor 2009 u dekretua

rikrijimi i Forcës Tokësore mbi bazën e Brigadës së Reagimit të Shpejtë dhe Regjimentit Komando.

Bazuar në misionin kushtetues, Forca Tokësore u përfshi në një proces transformimi të thellë e të gjithanshëm sipas koncepteve të ushtrive perëndimore. Me kalimin tërësisht të strukturave të kësaj force, nga një ushtri e shërbimit të detyrueshëm në një ushtri profesionale është rritur niveli i operacionitetit. Strukturat e Forcës Tokësore kanë pasur angazhime në Operacionet e Mbështetjes së Paqes në Bosnje-Hercegovinë, Irak, Çad dhe aktualisht operojnë në Herat, Kandahar, Af-



Forca Tokësore, pararojë e situatave kaotike të krijuara në vend

ganistan. Forca Tokësore mban peshën kryesore në operacionet paqeruajtëse në kuadër të NATO-s, OKB-së dhe BE-së. Në radhët e Forcës Tokësore drejtojnë kuadro të rinj, të kualifikuar në shkollat e ushtrive të vendeve të NATO-s, si në SHBA, Itali, Turqi, Gjermani, Angli, Austri, etj., me të cilët kemi projekte bashkëpunimi.

Forca Tokësore ka angazhime në operacione të emergjencave civile në ndihmë të komunitetit në rast fatkeqësish natyrore, si përmbytje, zhblokim rrugësh dhe shpërndarje ndihmash në rast rënie bore, operacione shuarje zjarresh, etj.

Forca Tokësore nga krijimi deri më sot është drejtuar nga komandantë me eksperiencë.

Në periudhën 2000-2006, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Kostaq Karoli;

Në periudhën 2006 - 2008, u drejtua nga gjeneral brigade Shpëtim Spahiu; Në periudhën 2008 - gusht 2012, nga gjeneral brigade Viktor Bërdo;

Nga gushti 2012 deri në nëntor 2015, Forca Tokësore u drejtua nga gjeneralmajor Zyber Dushku;

Nga muaji nëntor 2015 deri në janar 2019 nga gjeneralmajor Nazmi Cahani.

Nga shkurti 2019 deri në tetor 2020 nga gjeneral brigade Albert Mullai.

Në tetor 2020 Forca Tokësore drejtohej nga gjeneral brigade Arben Kingji, sot shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Forca Tokësore, e angazhuar në disa operacione në kuadër të Emergjencave Civile për fikjen e zjarreve. Pararojë e situatave kaotike të krijuara në vend, prej zjarr vënieve nga njerëzve të papërgjegjshëm, gjendet prej disa ditësh në njësinë administrative Shalë, Shkodër.

Batalioni i Parë i Këmbëorisë (b1k) zhvilloi një operacion për fikjen e zjarreve në fshatin Ndërsylaj, duke angazhuar në këtë operacion 40 efektivë dhe 3 mjete.

Po nga ky repart një efektiv prej 10 vetash dhe 1 mjet, zhvilluan një tjetër

operacion për fikjen e zjarreve në fshatin Urë e Shtrenjtë, njësi administrative Postribë, Shkodër.

Ndërsa efektivët e gatshëm të Batalionit të Dytë të Këmbëorisë (b2k) si dhe 14 efektivë nga Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS), ndërhyjnë për fikjen e zjarreve në fshatin Gjysyklanë, njësi administrative Pezë, bashkia Tiranë.

110 efektivë dhe 11 mjete të Forcës Tokësore nga Batalioni i Parë i Këmbëorisë, Batalioni i Mbështetjes me Luftim (bML) dhe Regjimenti i Operacioneve Speciale kryen disa operacione për fikjen e vatrave të zjarreve në fshatin Urë e Shtrenjtë, njësi administrative Postribë, Shkodër dhe në fshatin Skuraj, njësi administrative Milot, bashkia Kurbin.

Forca Tokësore, me kapacitetet që disponon, ngelet e gatshme për t'iu përgjigjur në çdo kohë dhe në çdo vend kërkesave në mbështetje të autoriteteve civile.





Kompania e Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë (MADM), ngelet një nga komponentët më të rëndësishëm të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë (GBKL). Për të rritur edhe më tej aftësitë e tyre operacionale, në kuadër të certifikimit të GBKL, këto ditë kjo kompani po trajnohet nga një grup specialistësh amerikanë të fushës.



Kontigjenti KFOR-2 i trupave Komando me mision në Pejë, Kosovë, kalon me sukses certifikimin “Fire Fobia” në “Camp Novo Selo”, duke rritur kështu aftësitë luftarake për përballimin e situatave të ndryshme.



Filloi në Forcën Tokësore, trajnimi mbi radiot e reja “Harris Type 1”, në interes të certifikimit të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë. Trajnimi zhvillohet nga ushtarakët amerikanë të komunikimit, në kuadër të bashkëpunimit me Gardën Kombëtare të New Jersey-it.

Përfundon në Forcën Tokësore, Stërvitja Individuale e Avancuar(SIA). Ky kurs, u zhvillua në të tre batalionet e Këmbëorisë së Forcës Tokësore, nën drejtimin instruktorëve të këtyre reparteve.



Arben Skënderaj

emërohet drejtor i QKMBMMFA-së



Z. Arben Skënderaj emërohet drejtor i QKMBMMFA-së. Një njohës i politikave mbi artin dhe kulturën, i cili është ngjitur disa herë në skenat shqiptare dhe europiane me instrumentin e tij, violonçelin. Modeli social i njeriut të thjeshtë, artisti i studiuar në Konservatorin Superior të Parisit, ku dhe është vlerësuar me çmim të parë. Themelues dhe organizator i disa festivaleve, i licencuar për vite me radhë nga Ministria franceze e Kulturës si menaxher arti. Ka zhvilluar një numër aktivitete të rëndësishme artistike dhe kulturore në fushën e muzikës klasike, si në Francë, ku shtrihet pjesa më e madhe e aktiviteteve të tij, po ashtu dhe në Shqipëri, ku prej disa vitesh ka themeluar disa struktura arsimore dhe kulturore, si dhe ka qenë i angazhuar në çështje të artit dhe kulturës, politikëbërjes, madje dhe në mbrojtje të mjedisit artistik dhe kulturor.

PËRFUNDOI KURSI I STËRVITJES INDIVIDUALE TË AVANCUAR

Në mjediset e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi, u zhvillua ceremonia e certifikimit të ushtarëve që përfunduan kursin e Stërvitjes Individuale të Avancuar.

Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 231 ushtarë në specialitetet këmbësori, detari, ndërlidhje dhe polici ushtarake.

Në këtë ceremoni morën pjesë ushtarakë, përfaqësues të forcave dhe familjarë të ushtarëve.

Fjalën e rastit në këtë ceremoni e mbajti Komandanti i QAPU-së, nënkolonel Bujar Fejzo. Ai falënderoi pjesëmarrësit në emër të Komandantit të AFA-së gjeneral brigade Albert Mullai, në mënyrë të veçantë ushtarët e sapo certifikuar në Programin e Stërvitjes Individuale të Avancuar, duke u uruar atyre suksese të mëtejshme në karrierën ushtarake.



Vizitë e atasheut ushtarak të Kosovës në Komandën e Forcës Detare

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës në vendin tonë, nënkolonel Enver Hoti. Ky takim u zhvillua në kuadër të takimeve që po realizon nënkolonel Hoti me rastin e marrjes së detyrës si atashe ushtarak në Tiranë.

Në takim u diskutua mbi realizimin e aktiviteteve të planit të bashkëpunimit ushtarak dhe perspektiva për të ardhmen, si dhe bashkëpunimi ndërmjet zhytësve tanë të Qendrës së Zhytjeve Pashaliman me pjesëtarët e FSK-së. Në fund të takimit kundëradmiral Adnand Agastra i uroi suksese në detyrën e re nënkolonel Hotit, duke theksuar se kjo frymë miqësore e bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen midis FSK-së dhe Forcës Detare.



Zhvillohet stërvitje e përbashkët trajnuese e palombarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Qendrës së Zhytjes

Për rreth 4 ditë u zhvillua një stërvitje trajnuese e përbashkët ndërmjet palombarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bashkëpunim me palombarët e Qendrës së Zhytjes dhe Flotiljen Detare Pashaliman.

Gjatë këtij trajnimi u zhvilluan zhytje ambiente deri në 3-12m, forma e kërkimit me mbështetje nga gomonia, orientim me busull dhe format e kërkimit me pamje kufizuese, eliminimi i pengesave gjatë kërkimit nën ujë.

Gjithë faza e trajnimit është realizuar me sukses dhe bashkëpunimi mes palombarëve të FSK-së dhe palombarët e Qendrës së Zhytjes dhe Flotiljes Detare do të vazhdojë edhe në të ardhmen në qëllim njohjen e pajisjeve dhe qendrave respektive.



Operacion SAR nga anija P-117 "Shiroka"

Qendra e Bashkuar Operacionale njoftoi për marrjen e një sinjali SOS nga një mjet turistik që ndodhej në rrezik. Mjeti tip jaht, me emër "Next Naval", që ndodhej 4 milje larg Lukovës dhe me destinacion Malin e Zi, kishte pësuar defekt dhe rrezikonte jetën e efektivit.

Duke qenë se kushtet e motit nuk ishin të favorshme kjo gjë e shtonte më tepër rrezikun dhe në këto kushte ndërhyrja e Rojës Bregdetare ishte vendimtare. Menjëherë u aktivizua sistemi SAR dhe anija e gatshme P-117 "Shiroka" që ndodhej në rajon dha ndihmën në kohë e duhur. Mjeti u rimorkiu dhe iu dorëzua autoriteteve në portin e Himarës.



Përfundon kursi "Bocman - Sinjalist" në Qendrën Stërvitore Bazë Detare, Pashaliman

Në Qendrën Stërvitore Bazë Detare, Pashaliman, u zhvillua kursi funksional "Bocman - Sinjalist". Ky kurs konsiston në marrjen e njohurive dhe aftësimin e personelit nënoficer dhe detar aktiv të cilët shërbejnë në funksionin e përgjegjës të kuvertës, në të gjitha klasat e anijeve të Forcës Detare.

Personeli pjesëmarrës në kurs mori njohuritë e nevojshme për kryerjen sa më mirë të detyrës si përgjegjës kuverte. Gjatë kësaj periudhe kanë përvetësuar njohuri të reja si, mbajtja në gatishmëri e pajisjeve, mjeteve dhe aparaturave të sinjalizimit të anijes në rast rreziku dhe mbajtjen në gatishmëri të sinjalistikës së lundrimit të anijes.



Gjeneral brigade Xhebexhia priti në një takim kortezie atasheun ushtarak gjerman, Dirk Weber

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Iliir Xhebexhia, priti në një takim kortezie atasheun ushtarak gjerman Dirk Weber, në kuadër të përfundimit të mandatit në Tiranë.

Nënkolonel Weber shoqërohej nga zëvendësi i tij në këtë detyrë, atasheu i ri ushtarak i Republikës së Gjermanisë në Shqipëri, nënkolonel Hans-Peter Wamsler.

Gjeneral brigade Xhebexhia duke u shprehur mirëseardhjen në këtë komandë, u uroi atyre njëkohësisht suksese në detyrat e radhës si për atasheun në ikje nënkolonel Weber ashtu edhe atasheun e ri të Republikës së Gjermanisë në vendin tonë, nënkolonel Wamsler.

Gjatë takimit ushtarakët e dy vendeve evidentuan fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcave të Armatosura gjermane, që nga arsimimi e trajnimi i ushtarakëve shqiptarë në fushën e logjistikës, mbështetjen konkrete me materiale didaktike, teknike dhe deri tek stërvitjet e përbashkëta midis dy vendeve, të zhvilluara ndër vite. Komandanti i Komandës Mbështetëse vlerësoi kontributin e çmuar të nënkolonelit Weber gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, për mbështetjen që ka dhënë në përgjithësi për Forcat tona të Armatosura dhe veçanërisht për Komandën Mbështetëse. "Nënkolonel Weber do të mbetet një mik i veçantë i vendit tonë dhe i Komandës Mbështetëse, për kontributin e shkëlqyer që ai ka dhënë në forcimin e partneritetit strategjik e sidomos në fushën logjistike midis Republikës së Gjermanisë dhe Shqipërisë", - theksoi gjeneral brigade Xhebexhia.

Nga ana e tij, nënkolonel Hans Peter Wamsler vlerësoi arritjet që Komanda Mbështetëse ka bërë gjatë kësaj periudhe, ai vlerësoi bashkëpunimin me këtë komandë dhe theksoi se ndihej krenar që shërbeu në një vend me një histori të madhe dhe të çmuar sikurse është Shqipëria. "Ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe shpresoj që nënkolonel Wamsler të bëjë më shumë për forcimin dhe intensifikimin e këtij bashkëpunimit sidomos



në fushën logjistike", - u shpreh ai.

Më tej, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Xhebexhia, uroi atasheun e ri ushtarak të Republikës së Gjer-

manisë në Shqipëri, nënkolonel Wamsler, për marrjen e detyrës së re dhe garantoj bashkëpunim të vazhdueshëm në fushën e logjistikës.

Specialistët EOD bashkë me zhytësit shqiptarë, turq dhe italianë pastrojnë thellësitë e detit të Vlorës

Një grup EOD i Batalionit të Xhenios (bXh) në Komandën Mbështetëse, kreu një operacion mbi identifikimin, transportimin dhe magazinimin e municioneve të paplasura nxjerrë nga thellësia e detit të Vlorës.

Ky operacion u krye në bashkëpunim me zhytësit e Qendrës së Zhytjes së Flotës Detare, zhytësit turq dhe ata italianë. Në operacion morën pjesë dy zhytës turq të anijes "Edenick", dy zhytës italianë të anijes "Alegro" dhe tre zhytës të Qendrës së Zhytjes së FD.

Nga ky operacion u nxorën nga thellësia e detit 22 predha artilerie dhe 2 djegore majore.

Pas nxjerrjes së municioneve, nga grupi EOD u bë identifikimi dhe vlerësimi i këtyre municioneve. Municionet u vlerësuan si të sigurta për t'u transportuar dhe, në masa të larta sigurie, u transportuan e magazinuan në bXh.



Atasheu ushtarak i Kosovës, vizitë në Komandën Mbështetëse

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, priti në një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, nënkolonel Enver Hotin. Ky takim u zhvillua në kuadër të takimeve që po realizon nënkolonel Hoti me rastin e marrjes së detyrës në Tiranë.

Në këtë takim të përzemërt gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, në fjalën e tij, vlerësoi bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve, veçanërisht në fushat e arsimit dhe stërvitjeve, duke u ndalur më shumë në traditën e mirë që po krijohet në zhvillimet e kurseve për Emergjencat Civile në Kosovë. Ai vlerësoi gjithashtu dhe rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmin e FSK-së sipas standardeve perëndimore.

“Ndhima e dhënë nga Forcat e Sigurisë së Kosovës në përballimin e situatave të krijuara në emergjencat civile, rritja e profesionalizmit të efektivave të saj, janë arritje për t’u vlerësuar dhe ne ndihemi krenarë që sot FSK është në gjendje që të kontribuojë për sigurinë e vendit të vet ashtu dhe atë të rajonit”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Xhebexhia.

Nga ana e tij, nënkolonel Hoti e siguroi komandantin e Komandës Mbështetëse se do ta çojë më tej bashkëpunimin ushtarak të dy vendeve tona si në atë të sigurisë ashtu dhe në përballimin e emergjencave civile.

Në përfundim gjeneral brigade Ilir Xhebexhia duke i uruar suksese në detyrë, e garantoi nënkolonel Hotin se Komanda Mbështetëse do të jetë pjesë në mbështetjen e pakursyer të FARSH për thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve.



Specialistët EOD eliminojnë rrezikun nga municionet e paplasura tek Unaza e Madhe, Tiranë

Gjatë kryerjes së punimeve në Lotin 5 të Unazës Madhe, për zgjerimin e shtratit të rrugës, u zbuluan 31 copë predha artilerie.

Me marrjen e njoftimit një grup EOD i Batalionit Xhenios (bXh) në Komandën Mbështetëse, me 6 forca e 2 mjete shkuan në vendngjarje dhe në masa të larta sigurie, kryen evidentimin e llojit të municioneve dhe rrezikshmërinë tyre.

Municionet ishin të kalibrave dhe llojeve të ndryshëm. Në gjendjen që ishin ato nuk paraqisnin rrezikshmëri për t’u transportuar, kështu u transportuan në vend-magazininim e tyre në bXh.





“Çfarë bën ti PËR SHQIPËRINË që Shqipëria të bëjë për ty?”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Sipas këtij parimi vlerësohen heronj, politikanë, shkrimtarë dhe artistë, qysh me të madhin De Rada, me “Milosaon” magji, Naim Frashërin me poemën madhështore “Bagëti dhe bujqësi”, poemat liriko-filozofike të Ndre Mjedës dhe poemat epike-patriotike të Fishtës, dhe mbërrin te kryemjeshtri, poeti i madh i mjerimit Millosh Gjergj Nikolla. Për çudinë tonë, të gjitha këto figura letrare të përkushtuara ndaj çështjes kombëtare, i ka ndjekur një fat i trishtë. De Rada vdiq i varfër, me një cironkë në xhep. Mjedën e përgjakën ushtarët

në prag të kishës, në mbrojtje të popullsisë së strehuar në kishë. Fishtën e lanë pa varr, ia hodhën eshtrat në lumë. Milloshi, që i këndoi aq bukur varfërisë, vdiq i ri, nga tuberkulozi, në një spital të Torinos, në moshën 27-vjeçare. Jetët e tyre! Ndaj për këtë gjë i duam shumë dhe i vlerësojmë edhe më shumë!

Pas viteve nëntëdhjetë, personalitete të nivelit të tyre, janë me gishtat e njëres dorë. Nuk kam ndërmend të anashkaloj çdo lloj suksesi të gjithkujt prej atyre që synojnë të mbeten në histori. Në letërsi ka disa emra të cilët kanë dhënë një kontribut të denjë për të qenë pjesë e ndritur e histories, referim për brezat e rinj, si Jakov Xoxa, Petro Marko, Sterjo Spase, Kolë Jakova, Rexhep Qosja, Dritëro Agolli. Një

rast tepër i veçantë është Ismail Kadare, me romanet “Dimri i madh”, “Kronikë në gur”, “Kështjella”, “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”, e sidomos poema “Përse mendohen këto male”, të cilat e vendosin denjësisht këtë shkrimtar të gjallë në listën e personaliteteve historikë.

Të gjithë ne jemi personazhe kalmantarë. Janë të tjerë ata që lindin “me këmishë” dhe me “yll në ballë”. Janë të tjerë ata që ndriçojnë qysh në lindje, e më pas, digjen si meteorë në fluturim për çështjen e madhe kombëtare. Ata janë të veçantë dhe të paktë si uraniami dhe floriri, por të nevojshëm dhe të domosdoshëm si ajri dhe drita për shoqërinë tonë. Historikisht, jeta e secilit prej tyre ka qenë herë e shkurtër e herë me një fund tragjik, por pasvdekja e

tyre iluministe mbetet plot dritë e shkëlqim. Nderim dhe respekt të thellë për të gjithë yjet dhe meteorët e kësaj toke!

Le të mos harrojmë, se i përkasim një populli dhe një kombi, se kemi një histori dhe një gjuhë, një traditë dhe një trashëgimi, një civilizim dhe një kulturë që burojnë nga një gjak.

Le të çlirohemi sa të jetë e mundshme, nga krahinorizmat që na kanë larguar nga njërin - tjetri,

Le të çlirohemi sepse ndarjet janë shumë më të dhimbshme se bashkimi.

I takon së kaluarës fajësimi i historisë dhe Europës. Në ato fajësime nuk ka asgjë të kontestueshme. Por, ardhmërinë e kemi në duart tona dhe këtë duhet të dimë ta shfrytëzojmë.

Mos të rrënojmë themele kur të tjerët ngrehin kulme.

Mos të mbajmë fjalime, por ta mbajmë fjalën.

Gabimet e tjetrit mos t'i vëmë përpara që t'i shohim, e gabimet tona mbrapa që t'i fshehim.

T'i përballojmë meritë dhe hasmeritë e së kaluarës dhe të përqendrohemi në ndërtimin e së ardhmes.

Të investojmë në kuadro me guxim intelektual, me maturi politike dhe shkathësi diplomatike.

Shqiptarët janë të kthyer me

sy e veshë nga Shqipëria, për t'iu përgjigjur pyetjes se ku do të jetë Shqipëria?

Puna e parë që do të duhej të bënin shqiptarët është që ta vesh-trojnë dhe ta shtrojnë çështjen shqiptare si një dhe të bashkuar. Po qe se këtë nuk e bëjnë shqiptarët, nuk mund të pritët që përpara tyre, ta bëjnë të tjerët, madje, edhe po qe se e bëjnë të tjerët, do ta bëjnë përpara në dëm të tyre se sa në interes të tyre.

Sipas një të vërtete se pa qenë mirë në Shqipëri, nuk do të jenë mirë as shqiptarët e shpërndarë anekënd botës.

Shqipërisë nuk mund t'ia sjellë askush tjetër, përveç se populli i saj, zhvillimin, paqen dhe sovranitetin.

Secili shtet e ndërton demokracinë në pajtim me mundësitë që krijon dhe, para së gjithash, me shkallën e vetëdijesimit të popullit, për ta kuptuar dhe, për ta ndërtuar atë në shtete.

Është detyrë e jona që Shqipërinë ta nxjerrim nga çdo udhëkryq në të cilin është ndodhur në historinë e jetës së saj.


Standardet demokratike të një vendi ose të më shumë vendeve Populli shqiptar është dalluar për trimëri, kurajë dhe besnikëri. Me penë dhe me pushkë, kanë arritur

të fitojnë lirinë dhe identitetin kombëtar që u takon. Edhe pse, historia pak herë ka qenë bujare me ne, sot, një kohë e re për popullin shqiptar ka ardhur. E ardhmja po shkruhet sot.... Dhe që ajo të jetë në favor të Shqipërisë, duhet që ne të ndryshojmë sadopak nga qenësia jonë. Shqiptarët njihen si "komb" i besës, virtyt që bota e mbarë e identifikon me këto troje. Në kohërat e luftës dhe të varfërisë, shqiptarët ishin gati të ndanin bukën dhe shtëpinë me çdokënd që kishte nevojë. Ata ishin shumë bujarë dhe të gatshëm për të respektuar. Populli ynë gjithmonë është përpjekur për të pasur një shtet të pavarur. Këto përpjekje e kanë zanafillën që në vitin 169 para Krishtit, kur mbreti ilir, Genci, u mposht dhe kryeqyteti i shtetit të tij, Shkodra, ra në duart e romakëve. Për këtë qëllim luftoi edhe Heroi ynë Kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu, vepra e të cilit është e njohur për ne. Më pas vjen Ali Pashë Tepelena me orvatjet për shtetin e tij, Bushatllinjët e me radhë. Pavarësia e Shqipërisë u shpall më 28 Nëntor 1912, farkëtar i saj qe Ismail Qemali, në krye të patriotëve shqiptarë, i përkrahur nga miqtë më të mirë në Europën Perëndimore.

Në Ballkan, kolonët në Stamboll e Rumani kishin bërë përpjekje të mëdha në shtypjen e materialeve, për të dëshmuar se jemi një popull me histori të lashtë, i cili nuk mund të mposhtet kurrë. Jo më pak bënë kolonët në Egjipt, SHBA e gjetkë.

Këto dokumente dëshmojnë pikërisht për atë zjarr të fuqishëm që ndriçonte si në zemrën e Plakut të Vlorës, ashtu dhe të patriotëve të tjerë nga të gjitha trevat shqiptare, por dhe për faktin e njohur se Shqipëria i takonte Europës Perëndimore, gjë që ish dëshmuar kohë më parë me Skënderbeun.

Në vitin 1880, z. G. J. Goschen, Ambasador në Kostandinopojë, në një telegram që i dërgoi Lordit Granville, shkruante: "Shqiptarët, si racë antike dhe e përcaktuar në mënyrë të mirëfilltë, si cilado prej të tjerave, prej të cilave rrethohen, kanë vënë re mbrojtjen e këtyre të fundit prej Fuqive europiane dhe realizimin e aspiratave të këtyre fqinjëve për një





ekzistencë më të pavarur. Shqiptarët kanë parë bullgarët të emancipuar plotësisht në Bullgari dhe të bëhen zotë të Rumelisë Lindore; kanë parë dëshirën e zjarrtë të Europës për të çliruar nga pushtimi turk territoret e banuara nga grekët; kanë parë sllavët e Malit të Zi, të mbrojtur me këmbëngulje të vendosur nga Perandoria e madhe sllave e Veriut; kanë parë zgjidhjen e Çështjes së Orientit, sipas parimeve të kombësive si dhe zgjidhjen e Gadishullit Ballkanik, të ndarë gradualisht prej racash të ndryshme, po sipas këtyre parimeve. Por, ndërkaq, shqiptarët shohin se ata vetë nuk trajtohen në të njëjtën mënyrë. Kombësia e tyre është shpërfillur dhe territoret e banuara nga shqiptarët i janë dhënë: në Veri, malazezëve, për të kënaqur Malin e Zi, që mbrohet nga Rusia; në jug, Greqisë, që mbrohet nga Anglia dhe nga Franca...

Po të ndërtohet një Shqipëri e fortë, preteksti për pushtimin e saj nga një forcë e huaj, në rastin e shpërbërjes së Perandorisë Osmane, do të ishte i papërfillshëm. Një Shqipëri e bashkuar do të bllokonte kalime të tjera për në Veri dhe Gadishulli i Ballkanit do të qëndronte në duart dhe nën kontrollin e racave që banojnë në të. Përndryshe, po të lindnin ndërlikime, shqiptarët do të na shkaktojnë vështirësi të pakapërcyeshme. Një popullatë, në pjesën më të madhe myslimane, mund të

jetë shkak shqetësimesh për vendet sllave ose greke, përreth. Jam i mendimit se, sipas masës së njohjes së kombësisë shqiptare, do të pakësohen mundësitë e ndërhyrjeve europiane në Gadishullin Ballkanik".

Ky ekspozim i rëndësishëm tregon drejtësinë e opinionit dhe largpamësinë e një burri shteti të Anglisë që, kohë më parë, jo vetëm kuptoi dhe përcaktoi kushtet shqiptare dhe qëndrimin e drejtë që duhej mbajtur lidhur me këto, por edhe parashikoi ngjarjet dhe padrejtësitë politike, që do të kushtëzoheshin nga mos vlerësimi i këtyre kushteve, gjë që mund të paraqiste rrezikun e një shkëndije që do të mund të përflakte gjithë botën. Po cilët janë ky vend dhe popull, për të cilët u thanë këto?

Ndërmjet Adriatikut, Pindit, vargmaleve Ballkanike, alpeve Dinarike, në vijën që ndan lindjen nga perëndimi, ku historia ka parë ndeshjet e kaq shumë popujve nomadë dhe lindjen e shumë qytetërimeve të reja, aty, si një fortifikatë natyrore e fuqishme, shtrihet Shqipëria. E mbrojtur nga pushtimet e huaja në të tri anët e veta nga male të larta dhe nga e ana e katërt prej detit, Shqipëria ishte e banuar fillimisht nga një racë, origjina e së cilës zë fill që në kohë të pellazgëve. Ndonëse jo e huaj ndaj qytetërimit grek, megjithatë kjo racë ruajti karakterin dhe krenarinë

e saj për origjinën para-helenike. Në shekullin II para Krishtit, vendi u bë strehë për të gjitha tributë maqedonase dhe epirote të cilat, për t'u mbrojtur nga pushtimet romake, ia mbathën me ardhjen e legjioneve të Paul-Emilit. Duke parë nga jashtë, territori shqiptar duket, në njëfarë mënyre, si i padepërtueshëm por, sapo hyn brenda, vë re vende dhe peizazhe të një bukurie dhe hiri të jashtëzakonshëm. Ndërmjet dy vargmalesh të thepisur e të zhveshur, që nga jashtë duken si pak tërheqës, shtrihen lugina të hirshme dhe fusha të gjera të begatshme. Prapa brezit shkëmbor dhe të thepisur, shtrihen fusha të gjera dhe pyje të gjelbra ose bojë ari, sipas stinëve. Në anët e grykave të frikshme dhe të vargjeve të ngjeshura të maleve, ndeshesh befas me oaze të bukura, të veshura me bimësi të harlisur. Përrenj bubullitës rrjedhin furishëm nga malet e thikta dhe shndërrohen më poshtë në rrëqe të kristalta e të qeta, që gjarpërojnë nëpër lugina të parfumuara, ku ngrihen pemë të shumta, gjithmonë të gjelbra dhe shkurre e kaçube të shpërndara në relievin ngjyrë smeraldi. Gjatë bregdetit, plazhe të kaltra dhe të qeta si edhe gjire të thella, vizatohen në këmbët e maleve, majat e të cilave janë të zhytura përjetësisht në retë që i shtyn era.

Kështu është vendi ku për shekuj

kanë banuar shqiptarët “bijtë e shqipës”. Duke pasur një lloj izolimi ata ishin quajtur, në mënyrë të përgjithshme, si maqedonas apo Ilirianë, sipas tekave të pushtuesve të ndryshëm. Por ata, krejtësisht indiferentë e mospërfillës ndaj nofkave që u ngjisin, të cilat nuk ndikonin aspak mbi racën e tyre, mbi gjuhën apo mbi karakterin kombëtar, duket se nuk preokupoheshin për rëniet e perandorive ose për ndryshimet e kufijve. Gjithmonë krenarë ata ruajtën pavarësinë e tyre, nga e cila asnjë fuqi nuk mund t’i privonte...

që në fëmijëri. Ai pranon më mirë vdekjen se sa një fyerje, që s’ka mundur ta lajë. Nuk ka interes apo konsideratë që të vlejë, në mendësinë e tij, më shumë se sa “besa” (fjala e dhënë). Përpara kufomës së babait apo të vëllait, do të respektonte në shtëpinë e tij, edhe vrasësin, në rast se më parë do t’i kishte dhënë “besën”. I huaji gëzon mbrojtjen dhe mbështetjen e të gjithë fshatit, edhe nëse vetëm njëri nga fshatarët, qoftë edhe më i parëndësishmi, do ia kish dhënë atij fjalën e nderit.

shkallë sa edhe më i thjeshti ndihet i njëjtë, “man for man”, me më të rëndësishmit. Bindja ndaj kryetarit është vetëm një formë e respektit, një detyrë, e fiksuar në mendjen e secilit, që në foshnjëri.

Lidhjet familjare janë tepër të forta te shqiptarët. Kryetari i familjes është drejtuesi, por jo tirani i saj. Ai drejton punët dhe zbatimin e vendimeve, të cilat merren bashkërisht. Bijtë e nipat, edhe pas martesës, vazhdojnë të jetojnë së bashku, në grup. Ka familje që banojnë nën një strehë ose në të njëjtën rrethojë, anëtarët e të cilave arrijnë në gjashtëdhjetë apo tetëdhjetë persona. Çdo krahinë e vendit përbën një shtrirje të territorit, brenda të cilit mendohet se fshatrat janë të populluara nga banorë të së njëjtës familje. Kjo sepse fjala “familje”, në Shqipëri, ka një kuptim shumë të gjerë se kudo tjetër në botën perëndimore. Sa shumë djem dhe vajza kontribuuan për këtë tokë, e cila çdo metër katror është larë në gjak

Po sot, pikërisht në këtë shekull të ri, ku ndjesitë patriotike duket se po pluhurosen, dhe “Na të bijtë e shekullit të ri”, të cilëve Migjeni na këndoi me lakonizmin e fjalës së dëlirë, kërkojmë çdo ditë të marrim nga atdheu gjithçka me pretendimin se na takon, Po ne vete, çfarë i kemi dhënë?!...

Gjithë mendimtarët, penë-artët dhe zemërluanët e vërtetë të këtyre trojeve kurrë nuk kërkuan gjë, por ndjenë detyrën e birit ndaj nënës.

Po sot kryefjala e fabulës:

Na ishte njëherë një shqiptar,

që dhe i lidhur në litar

Tek nderi e thirri


Vrig fluturoi

Për atdhe nënë e fëmijë

Dhjetra shpata trupin i përshkoi.

Rrënjët janë këtu, të forta si lisat e beshkëve të larta, detyra ndaj atdheut është më sublimja, ndaj le të punojmë për t’i ndritur faqen vatanit tonë, atë faqe të cilën historitë ndër breza donin t’ia njollosnin.

I kemi borxh atdheut, ndaj është koha ta shlyejmë!



Me gjithë konsekuencat fetare dhe pasoja të tjera që patën nga pushtimi turk, shqiptarët u mbetën besnikë dokeve e zakoneve të të parëve. Tri objektet e devotshmerisë për shqiptarin janë: nderi, familja dhe atdheu. Koncepti i nderit i është ngulitur shqiptarit


Shumë pranë kësaj ndjenje qëndron ajo e dinjitetit personal. Thonë, gabimisht, se Shqipëria është vend feudal. Në të vërtetë feudalizmi është i papajtueshëm me atë ndjenje të nderit dhe të pavarësisë personale, që është tipar i çdo shqiptari, gjer në atë

Spiunazhi, tradhtia dhe shoqëritë DEMOKRATIKE



KOLONEL HYSNI GJERGJI

• •
Eshtë folur shumë për spiunazhin dhe tradhtinë, janë krijuar mite dhe legjenda, janë paragjykuar dhe glorifikuar në vartësi të kohës, situatës dhe interesit. Deri në fillim të luftës së ftohtë, spiunazhit dhe tradhtisë i vishej edhe vello turpi, apo patriotizmi. Kjo në vartësi të palës që i vlerëson. Spiuni i njëjës anë është tradhtar për palën tjetër. Busti i Kim Filbit është vendosur në një shesh të Moskës, ndërsa në UK ai është tradhtari më i madh i luftës së ftohtë. Koloneli rus Oleg Penkovsky që spiunoi për SHBA-të, lidhur me krizën e raketave bërthamore, ka bustin e tij në Washington, por është i masakruar dhe pa varr në Rusi. Spiunazhi është vlerësuar si profesioni i dytë më i vjetër në botë pas prostitucionit. I radhitur në këtë mënyrë, është bërë për arsye të perceptimit që njerëzit kanë pasur dhe kanë për këtë profesion, por që nga ana tjetër është element i fuqisë kombëtare. Është në



natyren njerëzore të jetë kureshtar se çfarë tjetri bën, çfarë planifikon të bëjë apo dhe çfarë ai posedon. Shtetet dhe ushtritë kanë pasur nevojë të dinë për kundërshtarin sa i fortë ushtarakisht, ekonomikisht apo dhe moralisht.

Në fillim luftërat, por më vonë shtetet dhe biznesi e kanë ndjerë nevojën e informacionit për kundërshtarin. Sun Tzu në "Artin e Luftës" i quante spiunët si sytë dhe veshët e një ushtrie, pa të cilat ajo nuk mund të ekzistonte". Jul Cezari përcaktonte se "Tradhtari më i madh fshihet në vendin e fundit që ju do të mendoni". Aleksandri i madh kishte parimin "Grumbullo informacion për armikun sa të kesh mundësi, merri armikut iniciativën, dhe go-

dite në shtëpinë e tij". Xhorxh Washington si drejtues i luftës patriotike të Amerikës përcaktonte "Unë e urrej tradhtinë por i dua tradhtarët". Napoleon Bonaparte definon në strategjinë e tij: "më mirë një armik që e njeh, se sa një aleancë të fortë" dhe se "fshehtësia e luftës qëndron tek komunikimet". Winston Churchill e përkufizon në këtë mënyrë rëndësinë e vlerësimit të spiunazhit dhe tradhtisë: "Nëse nuk ke armik nga brenda, armiqtë e jashtëm nuk mund tju lëndojnë".

Në Mbretërinë e Bashkuar përcaktimi i spiunazhit është më i detajuar. Në ligjin e vitit 1911, një person kryen veprën e 'spiunimit', nëse ai, për çfarëdo qëllimi dëmton sigurinë apo interesin e shtetit, në rastet kur: afrohet, inspekton, kalon mbi ose është në afërsi, apo hyn në ndonjë zonë të ndaluar; bën ndonjë skemë, plan, model, ose shënim që është llogaritur të jetë ose mund të jetë, ose ka për qëllim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të jetë i dobishëm për një armik, apo; merr, mbledh të dhënat, publikon ose komunikon me ndonjë person tjetër për ndonjë sekret zyrtar, kode, password, apo ndonjë skemë, plan, model ose shënim, ose çfarëdo do-

kumenti tjetër i cili është llogaritur të jetë ose mund të jetë ose që ka për qëllim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që të jetë e dobishme për një armik.

I solla këta shembuj nga lid-ershipet ushtarake botërore në shekuj, për të theksuar ekzistencën dhe perfeksionin e spiunazhit dhe tradhtisë, në historinë e fitoreve dhe dështimeve të mëdha, të betejave dhe luftërave. Bashkë me diplomacinë, ushtrinë dhe ekonominë, inteligjenca në përgjithësi dhe spiunazhi në veçanti për një shtyllë nga katër, të fuqisë së një kombi.

Por çfarë është spiunazhi? Gjithkujt në mendje do t'iu vijë James Bond, me super sharm, super armë dhe aftësi super luftarake. Gjithkush mund të jetë një spiun, por vetëm ky tip mediatik me këto tipar jo. Po kundërspiunazhi? Kundërspiunazhi është tërësi masash që merren dhe veprimesh që kryhen, për të identifikuar dhe kundërvepruar ndaj kërcënimit të sigurisë, që vjen nga shtete, organizata ose individë të rekrutuar në shërbime inteligjente armiqësore dhe organizata terroriste.

Aktualisht dokumentet kryesore që NATO publikon dhe që normojnë punën e shërbimeve inteligjente e përcaktojnë spiunazhin si "veprimtari që kryhet nga një shtet, fuqi armike, ose në shërbim të tij, në mënyrë të fshehtë dhe të paligjshme, duke përdorur dhunë, shtrëngim, blerje ose rekrutim të personave që e posedojnë; që synon të fusë në dorë informacion të klasifikuar, sekretet shtetëror".

Po informacioni i klasifikuar sekret shtetëror çfarë është? Në terma ushtarake informacioni i klasifikuar është çdo dokument, shkresë, skicë, hartë, fotografi, imazh, film, pajisje, armatim apo program soft, ekspozimi i të cilit gjykohet së cenon sigurinë kombëtare.

Nga sa më lart, bazaru edhe në të dhënat e media-s për ngjarjen në hetim, në ish-fabrikën e armëve në Gramsh, javën e kaluar, arrihet në përfundimin se dyshimi për spiunazh është i arsyeshëm. Një objekt që ruhej me roje ushtarake, dhunohet siguria, u fotografua në fshehtësi, u reagua dhunshëm dhe me armë të ftohta kundër personelit të sigurisë.

Ata janë shtetas rusë qeveria e të cilëve e ka shpallur Shqipërinë vend armiqësor. Këto fakte mjaftojnë për të përkufizuar këtë ngjarje dhe falënderuar ushtarët tanë për kurajën, guximin dhe profesionalizmin e treguar. Kjo ngjarje vjen pak ditë, pas asaj të ndodhur më datë 7 gusht në Kosovë. Një tjetër "gazetare", Daria Aslamova u ndalua të futej në Kosovë, por vetëm pasi nga shumë agjenci të inteligjencës ishte vërtetuar si agjente e FSB-së.

Në praktikën e shërbimeve armike ndaj NATO-s dhe Shqipërisë, rrjedhimisht është e zakonshme praktika e zgjedhjes së mbulesës së besueshme, dhe e vijës së sjelljes pa dyshime. Për kryerjen e operacioneve relativisht të lehta këto shërbime edhe për rastin e Gramshit besohet të kenë përdorur nënkontraktorë. Kjo bëhet me qëllim që emri i tyre të mos gjendet askund në organikat dhe borderotë e shërbimeve inteligjente, edhe nëse ato posedohen nga kundërshtarët. Mënyra e përzgjedhjes së tyre është me dëshirë, shtrëngim, para etj.

Këto operacione "të maskuara" në përgjithësi janë 90% të hapura, dhe vetëm 10% veprimtari spiunazhi. Mjekët, gazetarët, eksploratorët, shkencëtarët, profesorët përdorin të drejtën e tyre të profesionit, por për të kryer edhe "pak" spiunazh. "Vija e sjelljes" dhe "mbulesa" e operacioneve të "maskuara", janë shumë të afërta me të vërtetën, më atë që duket, me ato që shfaqen, me atë që ato justifikohen agjentët nënkontaktorë. Ka një dallim midis asaj çka nënkuptohet në përdorimin e termave operacione të maskuara, dhe klandestine. Një operacion i maskuar ndryshon nga një operacion klandestin, pasi në të parin i kushtohet një rëndësi e madhe fshehjes se identitetit të sponsorit, kurse në të dytin i kushtohet një rëndësi e madhe mbajtjes fshehtë të operacionit në tërësi.

Forma më klasike e marrjes së informacionit nga inteligjenca armike, është nëpërmes tradhtarëve të shtetit, ushtrisë apo dhe inteligjencës të shtetit target. Inteligjenca armike do t'i kërkojë, gjejë, rekrutojë, drejtojë dhe motivojë këta "tradhtarë". Pse tradhtojnë? Rastet

deri tani kanë treguar që motivet e tradhtisë janë përmbledhur në akronimin "mice" që do të thotë: "Money - para, Ideology - ideologji, Coercion - shtrëngim, Ego".

Por lind pyetja, se çfarë e shtyn një individ të tradhtojë Agjencinë e tij të inteligjencës, dhe tipikisht atdheun e tij? MICE është akronimi që përdor NATO në doktrinën për inteligjencë dhe siguri. Para: roge e ulët? Grykësi? Nevojë për nevoja familjare? Borxhe? Ideologji: e urren sistemin ku jeton, admiron tjetrin? Kompromis (ose shtrëngim) është vulnerabël ndaj shantazhit? Marrëdhënie emotive me një agjent që i siguron aksesin? Ego (ose ndjenjë eksitimi): vuan nga vetmia? Është në kërkim të një personi për shoqëri? Nuk vlerësohet nga kolegët apo superiorët? Është në kërkim të vlerësimit dhe mirënjohjes? Dëshiron të jetë James Bond? Ç'është ego-maniak? Dëshiron të tregojë se mund t'ia dalë mbanë pa u lagur? etj.

Më të pëlqeshëm për kundërshtarët tanë rusë, janë dhe do të jenë "mole", urithët, siç i quajnë ata, agjentët e rekrutuar kryesisht brenda shërbimeve të inteligjencës kundërshtarë. Kështu ata do të përftojnë çdo informacion të kundërspiunazhit, që kundërshtari disponon, përfshirë informacion për emrat e agjentëve të dyfishtë në agjencitë e tyre. Dëmi në këto raste ka qenë i pa llogaritshëm kur analizojmë Kim Filbin, i cili iu shiti informacion rusëve. Britanikët, penetruan nëpërmjet Filbit, por ai nuk u zbulua asnjëherë, deri kur Anatoliy Golitsyn dhe Yuri Nosenko dezertuan nga KGB në SHBA dhe treguan për "urithët" (mole) brenda CIA dhe MI6. Kur e etiketuan tradhtar, Filbi iu përgjigj; "Tradhtar ndaj kujt? Ndaj asaj ideologjie që kurrë nuk i përkisja?"

Pas fillimit të luftës në Ukrainë u zbuluan edhe dy raste, që provojnë se Rusia synon të rekrutojë agjentë në nivelet më të larta të vendim-marrjes politike dhe të inteligjencës ushtarake. Rusët kishin arritur të rekrutonin një nga negociatorët e bisedimeve për paqe, të palës ukrainase. Denis Kireev, i besuari për të përfaqësuar interesat e popullit të tij, ia shet ato palës agresore. Pasi

Espionage and counterespionage go together like horse and carriage.

Charles McCarry

BrainyQuote

zbulohet, më 22 mars, ai ekzekutohet nga policia ukrainase duke u akuzuar për tradhti të lartë. Rasti i dytë është kapja nga kundërspiunazhi ukrainas SBU, të zëvendës drejtorit të kundërspiunazhit të rajonit të Kievit, më datën 10 mars 2022 . Ai ishte Dimitry Demyanenko, që u ekzekutua nga forcat e sigurisë së Ukrainës, pasi u zbulua si "mole" dhe tradhtar i Ukrainës për llogari të Rusisë.

Në disa raste janë bashkuar disa motive të tradhtisë, si në rastin e Robert Hanssen, një agjent i kundërinteligjencës së FBI-së, i cili i ofroi vullnetarisht shërbimet e tij KGB-së. Për shërbimet e tij Robert Hanssen, mori pagesa të majme, pasi nuk ndihej i vlerësuar nga FBI, dhe të spiunuarit në favor të rusëve kënaqte egon e tij. Disa herë, spiunët zbulohen edhe për shkak të shpenzimeve extravagante që kryejnë. Adeel Aakash dhe John Anthony Walker janë shembujt e spiunëve që punonin për rusët, të shtyrë vetëm nga përfitimi financiar. Estonezi që spiunoi NATO-n tek rusët në Estoni është Herman SIMM shef i departamentit të informacionit të klasifikuar të Estonisë. Në listën e

pagesës së SVR dhe ka përfituar gjithsej \$100 000

Autoritetet amerikane, në qershor 2010, kishin arrestuar për spiunazh dhjetë agjentë rusë, të cilët më pas janë shkëmbyer me katër persona që mbaheshin të burgosur në Rusi. Putin ka kënduar këngë patriotike bashkë me spiunët. Këtë e bëri të ditur vetë Putin, sipas të cilit, kënga bazohej në një himn të vjetër sovjetik të shkruar për spiunët rusë në Gjermaninë naziste.

Kërcënimet për gjyftime ose për vdekje janë format më direkte të kërcënimit. Mathilde Carré, një pjesëtare e Rezistencës franceze, u kap nga Nazistët dhe u kërcënua me torturë e cila do të evitohet nëse ajo do të kthehej në agjente të dyfishtë (double agent). Shembulli i spiunit "urith" i cili i dërgoi, Wikileaks mijëra faqe dokumente të klasifikuar të Zbulimit amerikan DIA ishte Bradley Manning. Me motivin se ishte i diskriminuar si homoseksual, ai mendohet se shkaktoi një dëm i cili llogaritet të jetë shumë më i madh se sa duket. Vlerësohet se nëse do të printoheshin disqet me dokumente në hard copy, do të duheshin

disa kamionë për t'i transportuar.

Spiunazhi po kthehet edhe në biznes fitimprurës. Nga një vepërimitaritetë shtetërore po kthehet edhe në interes për korporatat. Ka një filozofi të tillë në Japoni: "Përse të humbas 10 vjet kohë e miliarda dollarë për një studim në fushën e teknologjisë apo shkencës, në një kohë që me një shpërblim (blerje) prej 1 milion dollarësh të ofruar inxhinierit të firmës konkurruese, të njëjtin rezultat, e arrij më shpejt e më lirë".

Demokracia dhe shoqëritë e hapura demokratike, kanë sjellë edhe vështirësi në përcaktimin e kërcënimeve dhe monitorimin e sigurisë së vendeve perëndimore ndaj kërcënimeve nga inteligjenca ruse, kineze apo iraniane. E drejta e lëvizjes së lirë dhe të drejtat themelore të njeriut janë të shprehura dhe garantuara në dokumente të shumta ndërkombëtare të perëndimit. Nga ana tjetër këto lehtësi po përdoren kryesisht nga shtetet autoritare për të depërtuar me spiunazh.

Shoqëritë e mbyllura nuk lejojnë fjalën dhe lëvizjen e lirë, duke i izoluar ata nga e drejta për t'u informuar. Për demokracitë perëndimore, nuk ndodh që gazetarë të paguhën nga shërbimet zyrtare të inteligjencës për një aktivitet të tillë. Kjo do të përbënte skandal dhe do shoqërohej me protesta. Por ekziston mundësia që gazetarë patriotë të kalojnë informacione shumë të dobishme të grumbulluara prej tyre, përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre legjitim. Roli i media-s, dhe i gazetarëve në suksesin e inteligjencës në Ukrainë është një risi, ku gazetarët dhe operatorët e thjeshtë, japin informacione me shumë vlerë në mbrojtje të jetës së ushtarëve dhe qytetarëve ukrainas.

Spiunazhi, tradhtia dhe demokracia janë një trekëndësh, i cili funksionon me vështirësi duke mohuar apo mbivlerësuar njëri-tjetrin në vartësi të rendit politik, kohës apo interesit të vlerësuesve.

Duhet pranuar ndryshimi i mentalitetit të vjetër që "ajo që nuk shikohet nuk ekziston. Kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë kombëtare, jo të gjitha veshin uniforma ushtarake dhe mbajnë armë".

DED GJON LULI DEDVUKAJ, STRATEG I SHQUAR I KOMBIT SHQIPTAR

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI
Msc. Paul DEDVUKAJ (stërnip i heroit)
Msc. Alma GOLEMI

(Ky artikull është përgatitur në kuadrin e 110-vjetorit të themelimit të shtetit shqiptar, kushtuar Dedë Gjon Luli Dedvukaj (25.11.1840-24.9.1915), i cili ka qenë prijës e strateg i shquar i Malësisë së Mbishkodrës në luftën për çlirimin kombëtar dhe për ruajtjen e tërësisë territoriale të truallit arbëror. Është shpallur me titullin e lartë "Hero i Popullit" dhe Dëshmor i Atdheut me Vendim nr. 129 datë 3.11.1969 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Shkodrës, si dhe është dekoruar më 28.11.2015 nga Presidenti me "Urdhrin e Flamurit Kombëtar". Ai ishte bir i denjë i një treve me atdhetari të spikatur, i lindur për komandant, luftëtar i vendosur për çështjen kombëtare shqiptare, pjesëmarrës në LSHP më 1878, në Kuvendin e Greçës në 23.6.1911, jetën e lidhi me fatet e Shqipërisë në periudhën kritike të viteve 1911-1912. Prandaj Ismail Qemal Vllora gjatë vizitës së Heroit tonë në Vlorë pas shpalljes së Pavarësisë më 1912 e quajti atë me të drejtë "pushkë e ngrehur për Shqipërinë". Udhëheqës dhe luftëtar në Vermosh dhe në kretj veriu e trojeve shqiptare, ku e kërkonte interesi i kombit shqiptar, luftëtar për Hotin dhe Grudën, kundërshtar i vendimeve të traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit, luftëtar për bashkim kombëtar. Në qendër të Tiranës përveç memorialëve të Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe Hasan Prishtinës, më 27 Nëntor 2015 është vendosur një shtatore në qendër të Tiranës, në afërsi të Muzeut Historik Kombëtar, me plot meritë edhe shtatorja e heroit Ded Gjon Luli, simboli i trimërisë, mençurisë dhe mbrojtjes i idealeve të kombit shqiptar. At Shtjefen Gjeçovi e portretizon kështu Ded Gjon Lulin: "Shih i herë at' me flok t'bardhë./Që përpara u ka pri,/Ai asht ora e ksaj Malci,/Ai asht Ded Gjon Luli,/Që ma i fortë nuk bahet burri...". Dedë Gjon Luli mbetet simbolikë nga më madhoret të historisë sonë, strateg popullor i Malësisë në luftën për mbrojtjen e trojeve nga sulmet e fqinjëve veriorë, flamurngritës i Pavarësisë, në majë të Bratilisë në Deçiq të Alpeve shqiptare, flamurin e Gjergj Kastriotit, më 6.4.1911.)

VATRA QË LINDI HERONJ TË SHQUAR TË KOMBIT SHQIPTAR

Ded Gjon Luli është futur në kujtesën kombëtare të shqiptarëve si prijës, si luftëtar, si hero, si dëshmor, si udhëheqës i Kryengritjeve të Malësisë së Madhe, i ngritjes së Flamurit Kombëtar në Deçiq, për mbajtjen e Kuvendit historik të Greçës, ngjarje madhore që i paraprinë Pavarësisë së Shqipërisë. Ded Gjon Luli nuk i përket më vetëm Malësisë, trevë simbol të atdheadashurisë dhe qëndresës, legjendë e lëvizjeve patriotike për mbrojtjen e lirisë, sovranitetit dhe integritetit territorial. Fshati Traboin në atë periudhë i përkiste Sanxhakut të Shkodrës dhe Vilajetit të Shkodrës, ndërkohë që aktualisht i përket Komunës së Tuzit në Mal të Zi. Deda i përkiste oxhakut Dedvukaj të fisit të Hotit, ku në atë periudhë Hoti ishte i pari i bajrakëve të trevës së Malësisë së Madhe. Në këtë mjedis atdhetar do të lindte Ded Gjon Luli. Të shkruash për këtë tribun popullor është më shumë se përgjegjësi. Oxhaku i Gjon Lulit Dedvukaj, më 25.11.1840, u shtua me djalë dhe për këtë nuk munguan krismat e pushkëve. Djalin e quajtën Ded, si gjyshi, një traditë mbarë-shqiptare, emrin e gjyshit të tij të mirënjohur, Dedës, që edhe ky njihje për trimëri dhe për fjalën peshërendë në kuvendet e malësorëve. Gjon Luli kishte grua Lulë Keqen nga Vrithi i Shkrelit. Por fatkeqësisht babai i tij Gjon Luli kishte jetuar vetëm pak vite pas lindjes së djalit të vetëm që e kishte

pagëzuar me emrin e gjyshit të tij Dedë. Pas vdekjes së Gjonit nëna e Dedës, Lula ishte e detyruar të martohet, ndërsa Dedën e mitur do ta rriste pa i lënë gjë mangët xhaxhai (axha) i tij. Sipas zakonit malësor, Dedë Gjon Luli martohet i ri me të bijën e Gjelosh Marashit nga Gruda, Prenën me të cilën patën katër fëmijë: dy vajza, Naren e Mrinë si dhe dy djem: Gjergjin e Kolën. Babai i Dedës ndonëse kishte vdekur i ri kishte lënë një trashëgimi të pasur atdhetarie. Ded Gjon Luli i kishte dëgjuar dhjetëra herë fjalët e babës së tij, Gjon Lulit prej bashkëfshatarëve se, "...as drita nuk shkëlqen dhe as dielli nuk ngroh në këto troje deri sa të sundojë turku apo shkjaun tokën shqiptare". Deda i ruajti si një amanet të shenjtë, jo vetëm për vete e fëmijët e tij, por u mundua t'i kultivojë edhe te bashkëkohësit e tij me mjaft sukses. Deda e hodhi pushkën krahëve, nuk ka betejë, kryengritje apo kuvend, ku nuk merr pjesë ky trim si zana, që nuk i shkonte një plumb kot për armikun dhe nuk i binte një fjalë në tokë për mikun. Ded Gjon Luli Dedvukaj shumë shpejt u bë një nga luftëtarët më të papajtueshëm ndaj pushtuesve osmanë dhe dha maksimumin për ruajtjen e trojeve shqiptare të veriperëndimit jashtë orekseve të fqinjëve të uritur për të grabitur tokat e shqiptarëve. Ded Gjon Luli në pamje fizike ishte trupvogël, por me zemër të madhe, trim dhe me zgjuars natyrale që buronte nga mençuria e kultivuar brezave në Traboin të Hotit. Mjedisi i trevës malësore, vatrat e qëndresës janë malet-kështjella ku u lind, u rrit dhe burrërua, por edhe u mbryjt me idetë e lirisë dhe mëvetësisë Ded Gjon Luli. Ai mësoi kuptimin themelor të detyrimit kombëtar të përbashkimit, të vetëmbrojtjes, të luftës për liri e vetë-sundimin e Shqipërisë prej shqiptarëve. Kur i patën thënë Plakut të Flamurit, Ismail Bej Vlorës, i cili ishte ngritur në këmbë dhe e kishte përcjellë personalisht Ded Gjon Lulin vetë deri tek dera, "pse i bëtë kaq shumë nderime këtij katundari malësor?", ai me mençurinë karakteristike të labit ishte përgjigjur: "Ded Gjon Luli është pushkë e ngrehur për Shqipërinë".

AKTIVITETI LUFTARAK – PUSHKË E PARË PËR SHQIPTARINË DHE FIRMË E PARË NË MEMORANDUME (Kryengritja e malësorëve e identifikuar me emrin "Kryengritja e Ded Gjon Lulit")

Aktivitetin atdhetar dhe luftarak Dedë Gjon Luli e filloi që në moshë të re, ku spikati në Luftën heroike të Vraninës, ku trimi legjendar Oso Kuka, me aktin e tij heroik "paralajmëronte" fqinjët: "...Mos t'i lakmojnë tokës s'Gjergj Kastriotit./se u bjen shtrejt, qe besa e Zotit...". Ndërsa pushtimi ishte ulur këmbëkryq në trojet shqiptare, Ded Gjon Luli do të ishte pushkë e parë edhe në luftën e Kërnicsë më 1862, në luftën të Mulliri i Vrakës më 1871, në tre luftërat e Shpuzës më 1870-1877, në luftërat për mbrojtjen e Hotit, Grudës, Plavës, Gucisë, Ulqinit etj., që u zhvilluan nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 1878 deri më prill 1881. Gjatë viteve të LSHP Ded Gjon Luli ishte komandant i ushtrisë vullnetare të Lidhjes shqiptare të Prizrenit për Malësinë e Madhe dhe zëvendëskomandant i ushtrisë të Degës së Lidhjes së Prizrenit për Shkodrën. Por madhështia e gjeneralit popullor Ded Gjon Luli, spikati në vitet 1911-1912 në kryengritjet e mëdha popullore anti-osmane që çoi në ngritjen e flamurit kombëtar, më 6 prill 1911, në Bratili të Deçiqit. Deda ishte udhëheqësi i malësorëve kryengritës dhe që identifikohet edhe me emrin tij, si "Kryengritja e Ded Gjon Lulit". Urtësia e plakut të urtë dhe të mençur të Traboinit, bëri që baca Dedë të ishte dhe të ndihej si pushkë e parë dhe udhëheqës i parë edhe në luftërat për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga lakmitë e shovenëve serbo-malazezë të viteve 1912, 1913, 1915 dhe vitet që pasuan. Në kujtesën popullore, dhe jo vetëm, viti 1911 ka hyrë në histori si viti i një beteje shumë të rreptë dhe të përgjakshme, pothuaj katërmujore, në male, pati udhëheqës ushtarak malësorin 71-vjeçar Ded Gjon Lulin, i cili materializoi gjithë eksperiencën e shqiptarëve. Dedë Gjon Luli ishte pushkë e parë e

mbrojtjes të trojeve të bashkuara shqiptare, por edhe firmë e parë në memorandumet, kërkesa dhe protestat e 8 majit 1878, 13 qershorit 1878, 15 qershorit 1878, 16 qershorit, 2 korrikut, 7 korrikut, 7 tetorit, 22 tetorit, 8 nëntorit 1878, 21 shtatorit 1879, 1 marsit 1880, 12 marsit, 4 prillit, 2 majit, 18 majit, 16 korrikut, 7 gushtit, 15 shtatorit, 19 shtatorit 1880, 26 prillit 1883, 9 qershorit e 26 qershorit 1883, të majit 1903. Malësia e Mbishkodrës, dhe jo vetëm, e njohën Ded Gjon Lulin si organizator kryesor i Kuvendit të Greçës të 23 qershorit 1911, bashkëpunues themelor në formulimin e pikave të memorandumit të Greçës, që në fakt ishte një program politik për pavarësinë e trojeve shqiptare, për të vijuar me kërkesat e datës 9 shkurt 1912. Por kërkesat dhe protestat me shkrim, Ded Gjon Luli dinte t'i mbështeste edhe me zjarrin e armëve. Është fakt i dokumentuar se, më 10 prill 1911, zbret në Shëngjin fuqia ushtarake osmane nën Komandën e Turgut Pashës, e përbërë nga 34 bk, 20 mitraloza të rëndë e 24 topa malorë. Ishte koha kur të dy palët po përgatiteshin, osmanët për mësymje të përgjithshme, ndërsa malësorët për qëndresë tepër aktive. Pra momentin e zgjedhur nga Deda për fillimin e kryengritjes e përligjin fakte konkrete. Malësorët bëjnë organizimin e shkathët të mbrojtjes aktive. Turgut Pasha në Tuz vuri në rendim luftimi 11 mijë këmbësorë, 8 mitraloza të rëndë dhe 8 topa malorë me detyrë: të bllokojnë daljen e malësorëve në Mal të Zi, të pushtojnë Deçiçin dhe të marshojnë drejt Rapshtës. Në Koplik gjithashtu 11 mijë këmbësorë, 4 mitraloza të rëndë e 8 topa malorë: me detyrë të mos lejojnë ndihmën e Dukagjinit në të djathtë, të pushtojnë Kastratin e Shkrelin dhe të dalin në Rapshtë. Nga veriu, kryengritjes së malësorëve iu kundërvu Etem Pasha me 5 mijë këmbësorë, 8 mitraloza të rëndë e 12 topa malorë. Gjithë forca osmane përbëhej nga 27 mijë askerë, 20 mitraloza të rëndë, 28 topa malorë. Ndërsa Ded Gjon Luli shkëlqeu kur organizoi luftimet, duke i vendosur përballë armikut: 380 luftëtarë grudianë, 900 hotjanë, 100 luftëtarë të ardhur në ndihmë, 500 kastratas e shkrelas, 500 shaljanë në jug dhe 900 kelmendas në veri, pra gjithsej 3280 vetë. Raporti i forcave ishte 8:1 në favor të pushtuesve osmanë. Drejtuesi osman Turgut Pasha ishte arsimuar ushtarakisht në Turqi e Gjermani, ndërsa Dedë Gjon Luli e prijësit e tjerë kishin kryer vetëm akademinë e drejtimit në malet e veta. Turgut Pasha parashikonte operacionin e tokës së djegur dhe pat deklaruar se "do t'iu jap arnavutëve/shqiptarëve një mësim që të mos e harrojnë për shtatë breza". Por morën kundërpërgjigjen shqiptarçe, që u shkrua në histori si triumf i Malësorëve luftëtarë të paepur për lirinë e trojeve arbërore. Dedë Gjon Luli i mbrojti me gjak trojet e të parëve të trevës së Hotit, Grudës, Kelmendit, Trieshit, Kojës, Tuzit, Plavës, Gucisë, Ulqinit e të tjera troje që Europa dhe europianët kishin vendosur t'ua jepnin Malit të Zi, Serbisë etj. Në këto momente tragjike edhe pushtuesi shekullor osman ishte dobësuar tërësisht, sa ishte i gatshëm të lëshonte pa mëshirë territore shqiptare. Malësia e Madhe u shndërrua në vatër të madhe kryengritjeje e luftëra mbrojtëse dhe e qëndresës. Emri i burrit kreshnik të maleve, Ded Gjon Luli, si udhëheqës i malësorëve kryengritës, detyroi jo vetëm pushtuesin osman, por edhe kralinitë europiane ta njohin këtë malësor si tribun popullor të shqiptarëve liridashës. Nuk ka shqiptar sot që nuk është i bindur se, mjedisi që e rriti dhe burrëroi, qëndrimi i Dedës si ushtarak prijës në betejë, qëndrimi politik, lidhjet me atdhetarët bashkëkohës e bëjnë Ded Gjon Lulin si personifikimi i maleve shqiptare, në kuptimin organizativ vetëmbrojtës, ushtarak i fjalës së prerë dhe energjik në veprime edhe pse me moshë madhore. Shumëkush e krahason me malet shqiptare, si vatra qëndresë kundër pushtuesve. Vlerësimet për heroin tonë nuk kanë munguar edhe nga historianët në njohur të Europës. Kështu Profesori gjerman, dr. Ferdinand Huepe shkruan: "Vetëm në malet shqiptare u zbraps furia e valës sllave", ndërsa francezi Ciprion Robert thekson: "Malësitë janë nervi kryesor i Shqipërisë". Nga ana tjetër e shquara Dora d'Istria do shkruante: "...në malësitë e veriut ka gjetur strehë shpirti i pavarësisë së shqiptarëve", që janë vlerësimet në radhë të parë për prijësin dhe luftëtarin Ded Gjon Luli. Vlerësimet i referohen pikërisht diturisë dhe zgjuarsisë natyrale të Dedës si ushtarak, që krahasohet me gjeneralë të shkolluar në akademitë ushtarake europiane dhe ua tejkalonte gjeneralëve osmanë. Si ushtarak, gjeneral me aftësi të shquara, si në fushën e organizimit e mobilizimit ashtu edhe të komandimit, të shfrytëzimit me mjeshtëri të cilësive taktike e operative të terrenit të thyer malor. Deda dallohet si askush tjetër. Duke i njohur këto cilësi, në vitin 1879-1880 Dedën e shohim në detyrën e komandantit të forcave të Malësisë dhe zëvendës komandant të përgjithshëm në Jug, ku komandant ishte Preng Bib Doda e për qytetin e Shkodrës e



rrethet, Hodo Sokoli. Deda kishte aftësi të rrallë që ndjenjën fetare ta përdorte fort në shërbim të gështjes kombëtare. Duke qëndruar disa kohë në llogore, malësorët luftëtarë kërkuar të shkonin në kishë për të pasur meshë në një rast, por përgjigjia e Dedës ishte "Jo". Do të vijë prifti në llogore e do t'jua thotë meshën. Kështu edhe detyrën nuk e braktisim, edhe meshën e shohim". Kështu, duke tërhequr mbi vete forcën goditëse kundërshtare, viset e tjera kishin mundësi të shpërthenin kryengritje dhe në fund të fundit të realizonin qëllimin me lehtësi dhe pa humbje. Deda kujtohet si një udhëheqës i shquar i Malësisë së Mbishkodrës në luftën për çlirimin kombëtar dhe për ruajtjen e tërësisë territoriale të atdheut.

NGRITJA E FLAMURIT KOMBËTAR NË DEÇIÇ, NGJARJE KULMORE NË VEPRIMTARINË E DED GJON LULIT (Pushtimi i Bratilës dhe ngritja e flamurit)

Garnizonet ushtarake të Portës së Lartë nuk mundën të ndalonin veprimtarinë e luftëtarëve dhe trimave shqiptarë në Jug dhe në veri të vendit. Një prej ngjarjeve më kulmore të vitit 1911, një vit para pavarësisë ishte pikërisht Kryengritja e Malësisë së Madhe nga 24 marsi deri më 6 Prill 1911, ditë kur luftëtarët e Hotit pushtuan majën e Bratilës dhe me urdhër të Dedë Gjon Lulit. Ngritja e flamurit u la me gjakun e shtatë dëshmorëve: Dokë Preç Kercaj, Tomë Uç Ivanaj, Marash Lucë Gjokaj, Çak Uç Ivanaj, Gjeto Tomë Kolçaj, Kolë Dokë Marashaj, dhe Gjeto Gjokë Ivanaj, të cilët ranë heroikisht në fushën e nderit për flamurin kombëtar, dhe sot ata janë të përjetësuar në një memorial në Kojë. Nikë Gjelosh Luli vendosi flamurin shqiptar kuq e zi në Bratilë në afërsi të majës së Deçiçit. Ngritja e flamurit ishte pikë kulmore e Kryengritjes dhe treguesi më i qartë se qëllimi i Kryengritjes së Malësisë të vitit 1911 ishte luftë me qëllime të qarta për liri, komb dhe shtet

shqiptar të përbashkuar, një betim ky i prijësve të shtatë bajraqeve të Malësisë, Hot, Grudë, Kastrat, Kelmend, Shkrel, Triesh, Kojë por edhe fiset tjera jashtë Malësisë së Madhe. Malësorët me prijësit e fiseve që udhëhoqën Kryengritjen e Malësisë, në krye me krye prijësin e Kryengritjes, Ded Gjon Lulin, luftuan energjikisht për këtë flamur. Hotianëve u prinë: Ded Gjon Luli (vojvodë i Traboinit-Hotit), Nikë Gjelosh Luli, Gjokë Marash Gjeloshi, Gjon Nikë Plluci, Lulash Zeka, Zef Lan Ula, Kolë Marash Vata, Dedë Gjoni, të gjithë nga bajraku i Traboinit. Nga Rapshta e Hotit, Gjeto Marku, Lucë Muça, Zef Marashi, Luc Marku, Gjon Pllumi dhe Tomë Nikolla ("Vojvodë" është një term historik nga koha e sundimi osman, dhe do të thotë "i ngarkuar i qeverisë për një krahinë të caktuar në Shqipërinë e Veriut në shekullin XIX, i cili ndiqte zbatimin e urdhrave të qeverisë, sidomos pas reformës së Tanzimatit). Grudës i prinë: Ded Noli Martini (bajraktar i Grudës), Sokol Baci (Vojvodë), Kolë Zefi, Tomë Zik, Marash Dashi, Marash Ujka, Lucë Gjeloshi, Kolë Deda (Vojvodë), Tomë Gjoni si dhe Preng Ujka e në disa dokumente përmendet edhe e bija e Smajl Martinit (bajraktar i parë i Grudës), Tringë Smajllja. Kastratit (Selcës) i prinë: Dodë Preçi (bajraktar i Kastratit), Nikollë Doda, Mark Dashi, Mirash Luca, Gjelosh Gjoka (Vojvodë), Pjetër Gjoka, Dedush Marashi dhe Lulash Dashi. Kelmendit i prinë: Palë Luca (Vojvodë), Lucë Marku, Vocërr Preçi, Lucë Gjoni dhe bajraktari Gjon Voci. Vuçit i prinë: Gjon Uci (bajraktar), Dosh Prenka, Zef Uci (Vojvodë) dhe Lul Rapuka. Nga Nikçi: Gjon Sokoli dhe Lulash Kolë Shyti. Nga Shkrel: Tomë Nika, Prelë Preka dhe Zef Mali. Nga Shala: Mehmet Shpendi (Vojvodë), Marash Delia, Mark Alia. Në Kryengritje morën pjesë edhe Trieshi e Kojë që e printe bajraktari Pretash Zeka edhe pse në atë kohë ishin nën administrimin e Malit të Zi. Prej Deçiçit e më tej Vlorës së flamurit u përforcua urimi "Për flamur kombëtar", "Flamuri valoftë, në duart e shqiptarëve qëndroftë!", urim, që shpreh esencën e shpirtit, të identitetit dhe të idealit kombëtar. Ded Gjon Luli thoshte se: "Flamuri i ka të gjitha, ai ka besën, pushkën, ai ka brenda gjithë Shqipërinë.. atij i falen, atë e ndjekin mbrapa të gjithë, çka janë shqiptarë të vërtetë..". Ditët heroike kryengritëse të Malësisë së Madhe i përshkruan mrekullisht edhe poeti pogradecar, Lasgush Poradeci me vargjet: "Malësia që bëne sulm në zjarr-/Porsi dragojë me fletë/Siç bënte sulm ngadhënjimtar,/Gjergj Kastrioti vetë..". Ato ishin ngjarje madhore për kombin, ku kalitet ndërgjegjia kombëtare dhe farkëtohej liria, prandaj prijësit legjendar dhe trimit Ded Gjon Luli i këndohen këngë. Ded Gjon Luli, e justifikoi plotësisht jetën plot dinjitet dhe atdhetari si dhe nuk u përzhit kurrë prej flakëve të luftërave, por doli ngadhënjimtar mbi to, duke ngulur flakadan lirie në historinë e kombit shqiptar. Nëse i referohemi

Gjergj Fishtës në "Lahuta e Malësisë" gjithë krenrët e maleve i jep të përbashkuar, në luftë me pushtuesit: Oso Kuka, Mic Sokoli, Ded Gjon Luli, Çun Mula, Mehmet Shpendi, Marash Uci, Prengë Markola si "yll drite" etj., një kastë e klasë unike të urtisë, aristokracisë së maleve dhe qëndrësës shqiptare. Dhe në këtë kontekst padyshim Ded Gjon Luli mbeti përjetësisht një atdhetar i kulluar, që kur ishte fjala për trojet e veta nuk bëri kompromis me hasmin as për një fije bari. Për paralelizëm historik Ded Gjon Luli dhe dy djemtë e tij, Gjergji e Kola, janë dëshmorë të Atdheut, siç është dëshmor i flamurit dhe Nikë Gjelosh Luli, katër luftëtarë të përjetshëm të një oxhaku, që të sjell në mendje familjen heroike të Prekazit, "Jashari" në Kosovë.

NË VLORËN E FLAMURIT, SI FIGURË E QËNDRËSË SË MADHE SHQIPTARE

Historianë, gazetarë, analistë, studiues të fushës së historisë ushtarake, dhe jo vetëm, pyesin: "Ku ishte Ded Gjon Luli në ditën e shpalljes së pavarësisë?". 28 nëntori 1912 në Vlorë është shenjtëria e pavarësisë së Shqipërisë edhe pse ditë që mungoi fizikisht Ded Gjon Luli, që kishte gjysmë shekulli që mbante ndezur zjarrin e lirisë në trojet e Malësisë së Madhe dhe më gjerë. Armët e Ded Gjon Lulit nuk u ndryshkën kurrë, por "kënduan" fuqishëm për lirinë e shqiptarëve. Fletët e historisë mbartën e transmetuan prushin e ndezur të malësorëve kryengritës. Ded Gjon Luli ishte edhe frymëzues dhe që trimëri Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin e korifenj të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Ded Gjon Luli mungoi fizikisht në Vlorë në ditën e flamurit, por me veprën e tij atdhetare ishte prezent, ishte dhe është në krye të vendit, sepse pa Ded Gjon Lulin dhe luftën e tij me trimat malësorë, ajo ditë nuk do të kishte ardhur. Moshë 72-vjeçare dhe jeta si kaçak, duke jetuar më shumë jashtë në male e shpella. Këto kushte Dedës ia kishin rënduar moshën e pakësuar fuqinë për të shkuar atë ditë të flamurit në Vlorë. Por e kishte të pamundur edhe pasi rruga nga do të kalonte ishte plot rrezeje e erë baruti, ku përleshshin dy armiq shokollorë të malësorëve e shqiptarëve, Shkaju i Malit Zi që kërkonte të pushtonte Shkodrën e rrethuar prej tij dhe osmanëve, që kishte mbetur me një pjesë të ushtrisë së tij si trofe lufte, por që së bashku me Shkodranë e shqiptarë të tjerë po mundoheshin të mbronin veten e Shkodrën, ku në krye kishin Hasan Riza Pashën. Nga ana tjetër vështirësitë lidheshin me propagandën mashtruese të Kral Nikollës të Malit të Zi, që propagandonte se: "më ndihmoni të shporrim turqit nga Malësia e deri përtej Shkodrës, e ju kudo në këto vende që do t'i çlironi do të ngrini flamurin tuaj, dhe do të jeni zot të trojeve tuaja dhe ne nuk do t'ju biem më në qafë.". Mashtrimi malazez bëri që shumë malësorë të binin pre e mashtrimeve. Kur malësorët e kuptuan se çfarë po bënin ishte vonë. Trimëria e dhjetëra malësorëve kishte shkuar në dëm të tyre dhe në këtë gjendje të vajteshme që kishin rënë një pjesë e Malësisë, Dedë Gjon Luli nuk kishte si ia kthente shpinën trojeve të Malësisë së Madhe. Në fakt ishte Dedë Gjon Luli ai që ndezi gjakun e malësorëve për ta ngjallur qëndrësën malësore kur malet gjëmonin, ndërsa Europa bënte sehir: Frytet e kryengritjeve vilesin në Vlorë. Kështu Dedë Gjon Luli pas shpalljes së pavarësisë do të sfidonte moshën mbi 72-vjeçare dhe rrethanat e vështira të kohës dhe do të shkonte të takonte shpallësit e pavarësisë me në krye Ismail Qemal Bej Vlorën, me të cilin ishte takuar edhe gjatë kryengritjes antio-smane të Malësisë së Madhe në vitin 1911. Dedë Gjon Luli e siguroi Ismail Qemalin se te Malësia e Madhe do të kishte një mbështetje besnike dhe të palëkundur për qeverinë e Vlorës, si e para qeveri legjitime e shqiptarëve. Ka autorë që mos-presencën e trimit të Malësisë, Ded Gjon Lulit, në Vlorë e lidh me zinë familjare për vrasjen e të birit 22-vjeçar Gjergj Dedë Lulit. Megjithatë takimi u zhvillua, se burri i Malësisë besnike nuk mund të mungonte në Vlorë pak kohë pas pavarësisë, dhe pas takimit Ismail Qemali do të deklaronte fjalët lapidar se: "Ded Gjon Luli është pushkë e ngrehur për Shqipërinë", duke e pritur dhe përcjellë si rrallëkush.

HEROI DED GJON LULI NUK VRITET, POR QËNDRON NË PIEDESTAL TË KOMBIT

Vrasja e Dedë Gjon Lulit që prej vitit 1915 e deri më sot është trajtuar në shkrime të ndryshme në disa variante dhe shpesh edhe kontradiktore. Por vrasja e këtij patrioti të madh është ndër më të rëndat e shekullit të kaluar dhe ndër vrasjet më të bujshme në historinë e shtetit shqiptar. Ishte 24 shtatori i vitit 1915, kur Deda ballafaqohet me një pritë në Sheshëz afër Oroshit, e ku vritet pabesisht nga hordhitë serbe, që i printe kapiteni serb Gjura dhe që gjendej, jo rastësisht, në Mirditë me një kompani ushtarësh serbë. Ai edhe pse e parandjeu grackën, edhe pse e paralajmëruar miqtë që të mos udhëtonte në kohë të turbullta, për besë burrash shkoi në takim. Ai nuk njihje "çaste fundore" edhe në moshën 75-vjeçare, edhe kur i organizuan kurthin në Orosh. Deda kur nuhati kurthin dhe përpara i doli kapiteni serb, ai gjakftohtë u tha mirditorëve që e shoqëronin: "paskemi mbarue!". Megjithatë nuk e dha veten. As kur e prenë me bajonetë bashkë me pesë mirditorët, nuk e lëshoi veten, por e priti vdekjen trimërisht. Dora gjakatare serbe por dhe e bashkëpunëtorëve esadistë vepronin rreptë mbi prijësit dhe luftëtarët shqiptarë në ato ditë të trazuara dhe në shtetërrëthim të Oroshit të Mirditës. Duke i bërë analizë situatës gjykojmë se serbët ishin mjeshtër të ngatërresave dhe intrigave për të eliminuar shqiptarët, duke organizuar plane për të lënë përshtypjen që edhe vetë shqip-

tarët të ngatërrohen me njëri-tjetrin. Kapedani i maleve dhe prijësi i sprovuar në luftëra, Ded Gjon Luli kishte shkuar në Orosh të Mirditës për të realizuar një besëlidhje të madhe me parinë e Mirditës, por edhe më gjerë, për të koordinuar luftën çlirimtare e mbrojtëse të trojeve shqiptare nga pangopësia shekullore e fqinjëve të Ballkanit. Lufta e Parë Botërore, që filloi më 1914-ën kishte rrezik që të realizonte vendimet famëkeqe të traktatit të fshehtë të Londrës, të 26 prillit 1915, për të copëtuar edhe atë Shqipëri që kishte vendosur Konferenca e Londrës më 1913 nga Fuqitë e Mëdha. Prandaj burri i mençur Ded Gjon Luli si zemra, mendja dhe pushka e parë e Malësisë së Madhe dhe shqiptarisë, për më shumë se gjysmë shekulli, kishte sfiduar moshën, por edhe përbuzur rrezikun për jetën, duke u shndërruar faqja e bardhë e përjetësisë së Hotit, krejt Malësisë e Shqiptarisë. Të dhënat se serbët pasi i lidhin i kontrollojnë nëpër xhepa, për t'i vjedhur më parë. Deda e kupton këtë kontroll dhe nuk mungon të thotë "...kini kujtue se unë kam luftue tan jetën për pa-suri? Po kjo asht marre. Burri i Shalës lufton veç për vatan o shkja të ndymë!" Krismat e armëve presin në mes fjalës e trimit në mes por nuk mundën të presin frymën atdhetare dhe prushin e shqiptarizms për të drejtat e tyre legjitime. Bashkë me Ded Gjon Lulin u vranë dhe shtatë burra oroshas shoqëruet të Malësisë të madh. Shoqëruesit ishin nga fshati Lajthizë, ose siç quhen ndryshe "Shtatë Lajthizakët", që ishin Mark Llesh Doda, Ndue Kol Pjetri, Zef Ndue Gjoka, Preng Çup Deda, Preng Gjok Skana, Preng Bib Marlula dhe Llesh Deda, që të shtatë janë dëshmorë të kombit shqiptar. Fakt është se, për asnjë figurë tjetër shqiptare nuk janë sakrifikuar kaq shumë burra dhe kjo tregon rëndësinë që Mirdita i jepte një personaliteti të madh si Ded Gjon Luli, duke iu bërë vetë mburojë njerëzore një figurë madhore të kombit. Nuk do të vononte dhe rapsoji mirditor gdhendi në vargje vrasjen e shekullit: "Në bjeshkë të Oroshit na u derdh zani,/se ç'ban me ne serbani,/Si ata trimat kanë rrethue,/me vargonj na i kanë shtrëngue,/Zana e malit t'jam ankie,/curril gjaku tue u shkue,/Mu në Sheshëz burrit të botës,/pa iu tremb qerpiku i lotës,/Serbi thikën i ngul në krahnuer,/Ded Gjon Luli burrë malcuer,/Po i thotë këto fjalë açik:/Gjaku em të shkojë fli,/Për me pshtue të shkretën Shqipni". Ishte dita kur nga qielli shqiptar ishte shuar një yll i lirisë kombëtare. Pas vrasjes së Ded Gjon Lulit, falangat serbe, por dhe ato esadiste trupin e tij të pajetë e kishin mbuluar me lëndë drusore e gjethe në Malin Shejtë. Kanë qenë barinjët e zonës që e kanë zbuluar pas dy javëve. Më datën 8 tetor 1915, famullitari i Oroshit të Mirditës e varrosi pranë oborrit të kishës. Tri vite pas, më 1918, djali i tij Kola do ndërronte jetë si pasojë e helmimit, sërisht nga armiqët e shqiptarisë. Më 1920, në verilindje të Shkodrës do të binte me armë në dorë Luc Nishi, i biri i Nish Gjelosh Luli, i djathti i tij ndër beteja. Jo vetëm këta, por dhe nipi i Dedës, Zef Lan Ula, vëllai prej nëne, Baca Xheka, miqtë e shtëpisë Kolë Marash Vata, Kolë Kurti, e të tjerë, e zgjasin shumë listën e dëshmorëve për Atdhe të këtij fisi. Dedë Gjon Luli na mësoi se gjaku shqiptar nuk shuhet. Më 29 maj 1924 eshtrat e Dedë Gjon Lulit u rivarrosen me një ceremoni madhështore në Shkodër, me prani të më se tremijë vetëve që vajtonin heroin e kombit dhe bijtë e tij. Pjesëmarrës ishte edhe delegati Apostolik imzot Ernesto Kazi. Në këtë ceremoni një ligjëratë brilante mbajti At Anton Harapi: "Sikurse Athina e Roma mbi gjak e eshtna të fatosave ngrehen ndërtesën e Lirisë, ashtu për të mëkamunit e Shqipërisë u lyp që gjaku i kreshnikëve të stërpikë krepat e Maleve tona.. mbas 400 vjetësh Dedë Gjon Luli me çetën e vet lufton për të parën herë nën Flamurin e Shqipërisë, për lirinë kombëtare. Ai ka qenë tre herë fatos, se i fali Atdheut dy djemtë dhe veten, ...në të vërtetë horet fjala e popullit se, "ndihma e Zotit dhe pushka e Hotit e shpejtoi lirinë kombëtare të shqiptarëve..". Atë ditë nuk po varrosej Ded Gjon Luli, nuk shuhej ideali i tij, përkundrazi lartësohej një figurë madhore e kombit shqiptar, që mijëra shkodranë, dhe jo vetëm, shoqëronin trimin të mbuluar me flamur kombëtar në rrugëtimin në banesën e fundit, në një përcjellje solemne. Mbarë shqiptaria po përcillte një hero të papërsëritshëm. Nga Tirana, mbërriti dhe telegrami i deputetëve të Shkodrës, Luigj Gurakuqin e Hilë Mosi, në të cilin pos të tjerave thuhej: "Bashkohemi me zemër në nderimet që Shkodra po i kushton kujtimit të Ded Gjon Lulit, tue krye detyrën e mirënjohjes ndaj fatosit të pavdekshëm që nga më të parët ngrehi Flamurin e lirisë së atdheut, mbi shkrepat e përgjakura të Malësisë së Madhe". Historia e përqafoi, populli e hodhi në bronz për të mos u larguar kurrë nga memoria e kombit shqiptar.

DED GJON LULI PËRJETËSISHT NË MEMORIEN E LAVDISË SË KOMBIT

Penat për Ded Gjon Lulin janë të shumta, sepse e tillë ishte veprimtaria e tij mëmëdhetare. Prof. Shaban Demiraj, ish-kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në 85-vjetorin e Kryengritjes së Malësisë së Madhe, që më 13 prill 1996, mbajti një fjalë të rëndësishme për heroin në një simpozium kushtuar atij, po kështu dhe Pal Doçi e shumë të tjerë. Ded Gjon Luli është objekt i vlerësimit, fotografimit, nderimit, gdhendjes në bronz, pasi i tillë ishte ai vetë, kishte gdhendur një copëz të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar. Edhe në librin "Dëshmorët në rrënjët e kombit shqiptar", të prof. asoc. dr. Zaho Golemi, më 2021, figura e Ded Gjon Lulit, nuk përfaqëson një emër hero i dëshmor i por një epokë dhe një epike trimërie, mençurie e lavdie të birit të Traboinit të Hotit në

komunën e Tuzit. Profesorë të tjerë të spektrit të historisë ushtarake si Proletar Hasani, Shahin Leka, Bernard Zotaj, Bashkim Qeli, Dorian Koçi, etj., kanë evidentuar në shkrime të veçanta nderimin e një figure të lartë të kombit shqiptar: Pena të tjera e që e kanë nderuar veprën e Dedë Gjon Lulit kanë qenë Lasgush Poradeci, Zef Gjeta, At Bernardin Palaj, Ndue Bacaj, Xhevair Shtupa etj. Piktorë të shumtë janë frymëzuar nga vepra e Ded Gjon Lulit sikurse është piktura e piktorit Agim Zajmi "Ngritja e flamurit në Deçiq në vitin 1911" dhe dhjetëra piktura të tjera. Ai me meritë të plotë është shpallur me titullin më të lartë në Shqipëri që është titulli "Hero i Popullit" si dhe me titullin e lavdishëm "Dëshmor i Atdheut" me Vendim nr. 129 datë 3.11.1969 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Shkodrës. Për meritat e tij në luftërat dhe përpjekjet e popullit shqiptar për pavarësi, liri e përparim, Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar Ded Gjo Lulin "Për veprimtari patriotike të klasit të Parë" në kuadër të 50-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, më 28.11.1962. Emri dhe vepra e Ded Gjon Lulit është në tekstet e historisë dhe të letërsisë shqiptare, në monumente dhe në libra, në filma dhe emërtime rrugësh e shkollash, përjetësisht i gdhendur në memorien e kombit shqiptar. Ded Gjon Luli është dekoruar si Hero i Popullit dhe është i 24-ti në listën e Heronjve të Popullit nga 158 Heronj të Popullit të akorduar nga Kuvendi Popullor i Shqipërisë. Për Dedë Gjon Lulin është shkruar dhe do të shkruhet e vlerësohet sepse figura e gjeneralit popullor, malësorit atdhetar të kulluar, është përmendur fort në histori dhe është e njohur dhe e nderuar në mbarë shqiptarinë sepse për gjysmë shekulli jetë në shërbim të Atdheut i kanë vënë vullën me prush atdhetarie. Për të përkujtuar këtë figurë madhore të historisë së kombit shqiptar janë shkruar nga më shumë se 120 autorë, historianë, shkrimtarë, poetë nga më të mirët e kombit shqiptar.

Kronologjia e jetës dhe veprës së Ded Gjon Lulit:

25.11.1840. Lindi Dedë Gjon Luli. Ai kishte lindur me pushkë dhe për pushkë. Lindja e djalit u përcoll me batore pushkësh, siç edhe asht kenë zakoni. Por prova e parë e trimërisë së djemve të Malësisë përcaktohej nga pjesëmarrja në betejë, që në fakt u zhvillua në ndihmë të Oso Kukës, kur ishte në moshën 21 vjeç. Epopeja që shkroi Oso Kuka në Vraninë, që luftoi deri në frymën e fundit, nuk u dorëzua i gjallë, por i vuri zjarrin kullës ishte një shembull heroizmi dhe qëndrese për gjithë shqiptarët.

Shkurt 1842. Ded Gjon Luli i vdes i ati, Gjoni dhe mbetet pa baba, por rritja dhe edukimi i tij vijoi sipas traditave malësore. Jeta nuk e lëkundit Dedën aspak në djepin e ngrohtë. Pas vdekjes së babait të Gjon Lulit, tre muaj më pas e ëma e la Dedën e vogël në shtëpi, në kërkim të një fati më të mirë për veten dhe nuk mundi ta merrte Dedën me vete.

1861. Dedë Gjon Luli Dedvukaj ishte ndër luftëtarët që i shkuan në ndihmë Vraninës, sikurse shumë hotianë dhe malësorë të Grudës, në atë kohë Dedë Gjon Luli ishte pjekur plotësisht për të luftuar pushtuesit. Që prej kësaj kohe kudo ku kërciste pushka për "komb" e "Shqipni" në krye për krahinën ishte trimi i Gjon Lulëve. Në të gjithë malësinë e Shqipërisë së Veriut, Hoti ishte bajrak me emër, bajrak i parë, prandaj ai përfaqësohej në të gjithë kuvendet e më pasme.

1878. Edhe në Lidhjen e Prizrenit, Hoti pati përfaqësuesit e vet. Prijësi i ardhshëm Ded Gjon Luli, i frymëzuar nga betejat skënderbegiane të lirisë dhe të vetë-sundimit ishte trupëzuar në mendjen Dedës. Kjo duket qartë në kërkesat e vijueshme të tij. Në kuvendin me konsullin osman në Cetinë, pyetjes se atë "Librin e kuq" e duan për vete, a për gjithë Shqipërinë, Deda i përgjigjet: "Ma parë për vete e mandej për Shqipërinë mbarë"! Që Deda e kishte të qartë detyrën për të cilën luftonte, kjo është shprehur fort bukur në këtë këngë popullore: "Dedë Gjo' Luli shkruen një letër:/Pashës s' Shkodrës me ia çue./Se Shqypnia nuk do' t'jektër./Veç do vedin me e sundue!..".

1.3.1880. Malësorët i shkruanin ambasadorit të Austrisë: "...Të jeni të sigurt se po të ndodhë kjo padrejtësi që nuk e besojmë, do të ndodhin medoemos gjana të papëlqyeshme..." Në letër malësorët përcjellin mendimin e tyre se ata ishin të vendosur që të jetonin të patundur në viset e të parëve. Por në fakt fuqitë e Mëdha e kishin shitur Shqipërinë dhe trojet e saj.

4.4.1880. Malësorët e prirë nga Ded Gjon Luli, i kishin dërguar letër edhe konsujve të tjerë europianë në Shkodër, në të cilat u bënin të qartë betimin se asnjë copë tokë nuk do të lëshonin pa luftë, duke ua bërë të qartë se nuk i pranionin vendimet e padrejta të Kongresit të Berlinit dhe ishin betuar që tokat e tyre, mos me i lëshue pa luftë.

29.1.1886. At Agostini, frati i Brigjës, në një relacion që i dërgon Arqipeshkëvisë së Shkodrës shkruan: "Shumë i ndershmi Dedë Gjon Luli, i pari i arratisun, gjendet në kushte shumë të vështira jetese, i mungon deri buka ..shtëpinë e tij të djegun sapo e kanë mbuluar në një qoshe. Të ndihmohet se është ma i ndershmi dhe ma i dashtuni në këto male".

5.3.1899. Ded Gjon Luli është ndër përkrahësit e zjarrit të nënshkrimit të një vendimi me shtatë pika në Shkodër, në të cilën në emër të të gjithë vilajetit të Shkodrës u shpall besa dhe bashkimi i popullsisë së këtij vilajeti me Kuvendin apo Lidhjen Shqiptare të Pejës të 26-30 janarit 1899 dhe komitetin e saj të kryesuar nga udhëheqësi

trim e patriot Haxhi Zeka.

27.2.1904. Në letrën që i çon arqipeshkvit të Shkodrës thekson: "Në qoftë ndokush meshtar shqyptar gjakut e vllaznisë sonë po e përbejë për mund e gjak të Skanderit, që ka dërdhë për Shqypni të na dalë zot te zotnia jote".

Fillim marsi 1911. Mirditorët sulmuan garnizonet turke në Orosh e Kashnjet. Komandanti i Divizionit 24, i dislokuar në Shkodër e çmoi gjendjen si shumë të rrezikshme. Për të përballuar sulmet në Mirditë tërheq nga Tuzi 4 batalione këmbësorie dhe, duke u shtuar edhe disa të tjerë nga Shkodra, nën komandën e shefit të shtabit albay (kolonel) Pertef beut, i nisi urgjent në Mirditë. Edhe nga Prizreni në drejtim të Mirditës u dërgua një detashment këmbësorësh i shoqëruar me artileri malore.

24.3.1911. Duke parë se garnizoni i Tuzit ishte pakësuar shumë, prandaj një sulm i befashëm do të çonte patjetër në sukses, Deda dërgoi Nik Gjelosh Lulin dhe të birin, Kolën për të nisur këtë sulm, sulm që rezultoi i suksesshëm dhe merret posta e Rapshtës.

25.3.1911. Kryengritësit marrin postat në Stare, Pikale e Selishtë, ndërsa Kelmendi theu kishën e mori armët e mbledhura aty që në vitin 1910.

27.3.1911. Kryengritësit e udhëhequr nga mençuria e Dedë Gjon Lulit sulmuan e morën disa pozita dominuese rreth Deçiqit, ndërsa Kelmendi mori dy postat e Vermoshtit. Atë ditë, në drejtimin Koplík-Kastrat u nisën nga Shkodra 500 ushtarë, 4 topa, 1000 vullnetarë shkodranë, por u ndalën për 3 ditë në Përrua të Thatë nga forcat e Kastratit nga prijësi Dodë Preçi.

28.3.1911. Kryengritësit sulmojnë Tuzin, i cili të nesërmen bie në dorë të kryengritësve. Kështu u krijua një zonë e lirë nga Tuzi e gjer në Drin, duke mbetur në duar të osmanëve vetëm Shipçaniku e Deçiqi.

30.3.1911. Pushtuesit osmanë kundërsulmojnë nga Shipçaniku në drejtim të Deçiqit, por besojnë humbje të konsiderueshme dhe sulmi i tyre quhet i dështuar.

31.3.1911. Në mesnatë allbay Pertef Beu, pas një pune mashtruese, mundi të tërheqë prej Mirditës gjithë ushtrinë e tij pa pësuar dëmtime dhe hyri në qytetin e Shkodrës.

1-2.4.1911. Malësorët e kanë ditë Pashke dhe nuk nxjerrin roje, kështu që forcat osmane nga Përroi i Thatë shkojnë në Deçiq e që andej në Shipçanik.

3.4.1911. Dedë Gjon Luli mbërrin në Qafë Kishë dhe vihet në krye të forcave kryengritëse.

6.4.1911. Në Kalivare të Mirditës, Kuvendi i 12 bajrakëve zgjedh Preng Marka Prengën komandant të përgjithshëm të forcave kryengritëse të Mirditës.

10.4.1911. Në Shëngjin zbrit fuqia ushtarake osmane nën Komandën e Turgut Pashës e përbërë 34 batalione asqerësh, 20 mitraloza të rëndë e 24 topa malorë. Turgut Pasha në Tuz vuri në rendim luftimi 11 mijë këmbësorë, 8 mitraloza të rëndë dhe 8 topa malorë, ndërsa në Koplík gjithashtu 11 mijë këmbësorë, 4 mitraloza të rëndë e 8 topa malorë. Etem Pasha me 5 mijë këmbësorë, 8 mitraloza të rëndë e 12 topa malorë. Gjithë forca osmane përbëhej nga 27 mijë asqerë, 20 mitraloza të rëndë, 28 topa malorë. Ndërsa Deda Gjon Luli shkëlqeu kur organizoi luftimet vetëm me 3280 luftëtarë.

6.4.1911. Trimat kryengritës çuan në vend amanetin e Gjergj Kastriotit dhe fjalën e prijësit atdhetar Dedë Gjon Luli, duke e ngritur flamurin kombëtar në majën Deçiqit, që u la me gjakun e shtatë dëshmorëve Kojas: Dokë Preç Kercaj, Tomë Uc Ivanaj, Marash Lucë Gjokaj, Çak Uc Ivanaj, Gjeto Tomë Kolçaj, Kolë Dokë Marashaj, Gjeto Gjekë Ivanaj, të cilët ranë heroikisht për flamurin kombëtar shqiptar. Ndërsa Nikë Gjelosh Luli, Gjon Ujkë Miculi dhe Pjetër Zefi janë flamurtarët e shqiptarisë. Atë ditë (më 6 prill 1911) Lekët e Hotit, Grudës, Trieshit, Kojës, Orahovës, Fundnave, Kastratit, Kelmendit, Shkrellit e të tjerë, mbas fjalës së Dedë Gjon Lulit: "Bini, bini sokola, he në krajini ju shkoft zani". Deçiqi është "Oxhaku" i shqiptarisë, që poeti Aleksandër Sirdani i këndon: "Nalt Flamuri përhillët./Armikut s'i lëshon cak./Me besë Arbnori lidhet./Me gjakë mbrojt Atdheun me gjakë./Ngallnjyese kthen Malësia./N' Deçiq Flamuri të valojnë./Plot gjak e jetë i kushtojnë./Kuq e Zi Flamuri përhillët./N' dor Ded Gjo' Lulit trim./ me Gurakuqin mblidhet./Shqipnia me një kushtim". 6 prilli i 1911-ës përkujtohet edhe si "pranvera e Flamurit", sepse Malësia e Ded Gjon Lulit e ka ngritur flamurin përpara Vlorës në majën e Bratilës në Deçiq, ku me urdhër të Dedë Gjon Lulit, Nikë Gjelosh Luli vendosi Flamurin Shqiptar kuq e zi në Bratilë pranë majës së Deçiqit. Ded Gjon Luli kishte hedhë për tokë flamurin me gjysmë hënë të osmanëve, ndërkohë që ishte dita kur do të binte i pari si dëshmor i fisit, Nik Gjelosh Luli.

23.6.1911. Memorandumi i Greçës u shkrua nga Ismail Qemal bej Vloja dhe Luigj Gurakuqi, që u quajt edhe "Memorandumi i Greçës" ose "Libri i Kuq" (për shkak të ngjyrës së ballinës së broshurës në të cilën u shtyp), me 12 kërkesa, ku spikat kërkesa për autonominë territoriale-administrative të mbarë Shqipërisë, ndërkohë që Ded Gjon Luli edhe pse në moshë të thyer i qëndroi besnik deri në fund luftës për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar të bashkuar. Me nismën e Komitetit të kryengritjes (të Podgoricës), u mblodh në pllajën e Greçës, në perëndim të Selcës, në Malësinë e Madhe Kuvendi i Përgjithshëm

i krerëve shqiptarë, i cili më 23.6.1911 miratoi dokumentin, i cili u paraqit Kuvendit të krerëve të kryengritjes nga Luigj Gurakuqi. Memorandumi u shkrua në shqip dhe frëngjisht dhe u nënshkrua nga Sokol Baci (Grudë), Ded Gjon Luli (Hot) Ded Nika (Grudë), Dod Preçi (Kastrat) Tomë Nika (Shkrel), Cal Dedi (Selcë), Lulë Rapuka (Vukel), Llesh Gjergji (Nikç), Gjeta Mark Ujka (Hot), Mehmet Shpendi (Shalë), Avdi Kola (Gimaj), Nikë Mëhilli (Shllak), Tup Cuni (Prekali), Binak Lulashi (Toplanë), Bash Bajrami (Nikaj) dhe Bek Delia (Dukagjin).

24.6.1911. "Libri i Kuq" iu dorëzua nga përfaqësuesit e kryengritësve ambasadorit turk në Mal të Zi, Sadredin Beut, që e pranoi atë pa dhënë ndonjë përgjigje. Për të pasur garancinë e Fuqive të Mëdha për plotësimin e kërkesave të tyre, një delegacion i kryengritësve, i përbërë nga Luigj Gurakuqi, Dedë Gjon Luli, Sokol Baci etj., ua dorëzoi Memorandumin e Greçës përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Cetinë. Marrëveshja ishte një akt, një program kombëtar, me të cilin kryengritja e armatosur e shqiptarëve të veriut kishte objektiva të sakta për ardhmërinë e shqiptarëve.

26.6.1911. Duke përfutur nga memorandum, që kryengritësit shqiptarë ua drejtuan Fuqive të Mëdha, Eduard Grej, ministri i Jashtëm britanik, kërkoi të ndërhyhej kolektivisht pranë Portës në përkrahje të shqiptarëve, për gjuhën, shkollën, ndërtimin e rrugëve dhe për amnistinë e përgjithshme, por ky propozim nuk gjeti përkrahje të fuqive të tjera të mëdha.

Gjermania kundërshtoi se do të merrej nga Stambolli si ndërhyrje në punët e brendshme të Turqisë; Vjena u përmbajta tek qëndrimi i mëparshëm, të mosndërhyrjes; Franca nuk u bashkua me nismën e Anglisë, Rusët shprehin dyshimin nëse shqiptarët do të kënaqeshin me lëshimet e propozuara nga Grej kur ata kërkonin autonomi.

07/08.1911. Pas Memorandumit, shqiptarët filluan të punonin për ta shtrirë kryengritjen në të gjithë vendin, për ta kthyer në një kryengritje të përgjithshme në veri e në jug të Shqipërisë.

12.7.1911. Shqiptarët, duke parë interesimin e Foreign Office-it anglez, në një memorandum të veçantë që i drejtuan qeverisë angleze, posaçërisht Eduard Grejit, kërkuan dhe një herë autonomi në Shqipërisë. Në memorandum thuhej: "...po bëjmë fil për arsye të larta politike dëshirat e pavarësisë që frymëzojnë popullin shqiptar prej pesë shekujsh, e lypim vetëm autonomi të gjerë...", "...ushtria osmane po ushtronte në fshatrat e Malësisë, ku plaçkiste, digjte e rrëronte çdo gjë, ndërsa shqiptarët i lironin ushtarët osmanë që zinin rrë, turqit hakmerreshin edhe mbi popullsinë e pa armatosur, mbi pleqtë, mbi gratë e fëmijët... kishte edhe raste kur njerëzit digjeshin të gjallë nga asqerët..."

21.7.1911. U mbajt në Manastirin e Cepos, në Malin e Gjerë (Gjirokastrë), Kuvendi i përfaqësuesve të popullsisë së Çamërisë e Labërisë dhe gjithë kazave të vilajetit të Janinës, ku morën pjesë rreth 800 veta, edhe përfaqësues të çetave të armatosura të Shqipërisë së Jugut. Kuvendi miratoi një memorandum, i cili, duke pasur 43 nënshkrime të popullsisë së Gjirokastrës, të Delvinës, të Kurveleshit, të Himarës, të Filatit etj., iu dërgua qeverisë xhonturke. Memorandumi përkrahu fuqishëm Kryengritjen e Malësisë së Mbishkodrës dhe programin e saj të autonomisë së Shqipërisë.

29.8.1912. Ranë në fushëbetejë shumë luftëtarë të Malësisë, dhe ndërmjet tyre edhe biri i tij, Gjergj Dedë Luli 22-vjeçar. Kjo e ligështoi, por nuk e mposhti heroin. Historia ushtarake shqiptare ka evidencuar se në betejën e 29 gushtit 1912, kishin rënë shumë luftëtarë. Kur do t'ia jepnin lajmin Dedës, për të mos e lënduar, i thanë: "Dedë, kanë mbetë njëzet hotianë në fushë të luftës. - Po burrat në luftë do të mbesin, që përgjigjur ai. - Po mbeti dhe djali yt, Gjergji. - Po dhe ai djali nane ishte", - që përgjigjur Deda, duke e gëlltitur dhembjen.

24.9.1915. Në Sheshëz afër Oroshit, në grykën e shpellës së Akullit, nga një pritë e bërë nga serbët bie për të mos vdekur kurrë trimi i Malësisë, luftëtari dhe prijësi 75-vjeçar Ded Gjon Luli. E tërë jeta e Dedës dhe familjes së tij është një shembull i papërsëritur atdhetarie, një familje që nuk mund të shuhet kurrë sepse do ngelet një flakadan atdhetarie, që kujtohet e nderohet për bëmat në emër të Atdheut. Bashkë me Dedën ranë edhe 7 shoqëruesit e tij, siç njihen "shtatë lajthizakët": Mark Llesh Doda, Ndue Kol Pjetri, Zef Ndue Gjoka, Preng Qup Deda, 5. Preng Gjok Skana, Bib Llesh Marlula dhe Llesh Nue Deda.

8.10.1915. Pas vrasjes së Dedë Gjon Lulit, trupat serbe dhe esadiste trupin e tij të pajetë e kishin mbuluar me lëndë drusore e gjethe në Malin Shejtë në Orosh, ku e zbuluan disa barinj shtesisht pas disa ditëve. Më 8.10.1915, famullitari i Oroshit e varrosi te kisha e tij.

1918. Kolë Ded Luli, djali tjetër, krahu i djathtë i Ded Gjon Lulit ndër beteja, dha shpirt i helmuar nga armiqtë e kombit shqiptar.

1920. Në verilindje të Shkodrës, ra në fushëbetejë me armë në dorë Luc Nishi, i biri i Nish Gjeshos Lulit dhe nipi i Dedës, Zef Lan Ula, vëllai prej nëne, Baca Xheka, miqtë e shtëpisë, Kolë Marash Vata, Kolë Kurti, e të tjerë që zgjasin listën e dëshmorëve për Atdheun të këtij fisi e oxhaku të shquar të kombit tonë.

29.5.1924. Me përpjekjet e së bijës Nareja dhe e reja Nora, (bashkëshortja e Kolës), u mbartën prej Oroshit eshtrat e Ded

Gjon Lulit dhe prej Vlorës ato të Kolë Ded Lulit dhe u vendosën në Shkodër (ish-Kryeqendër e Vilajetit), sepse varrimi i të vrarëve bëhej "ku i zinte balta", një traditë e hershme e luftëtarëve që binin në beteja. Shkodra i nderoi vetëmohimin e familjes Gjon Luli për veprën e madhe e të ndritur të tyre. Eshtrat e Ded Gjon Lulit u riarrosen me një ceremoni madhështore të organizuar nga Etnit Franceskan në Shkodër, me pjesëmarrje të mbi tremijë vetash, si dhe delegati Apostolik imzot Ernesto Kozi. Eshtrat e Ded Gjon Lulit ishin mbuluar me flamur kombëtar. Në këtë ceremoni një ligjëratë brilante mbajti At Anton Harapi, i cili tha: "Sikurse Athina e Roma mbi gjak e eshtna të fatosave ngrehen ndërtesën e Lirisë, ashtu për të mëkamin e Shqipërisë u lyp që gjaku i kreshnive të stërpikë krepat e Maleve tona..."

18.3.1964. Ndërron jetë Nora, pjesëmarrëse e të gjitha luftërave të lavdishme për çlirimin e vendit dhe bashkimin gjithë shqiptar dhe dëshmitarja e fundit e vrasjes në pritë të një luftëtari të spikatur kombëtar, Ded Gjon Lulit, i cili e thërriste Norën (bashkëshortja e të birit Kolë Ded Lulit), me përkëdheli "Djali ma i mirë i babës".

13.4.1995. Në Universitetin Fordham në New York të SHBA-së Ismail Kadare shprehej: "Ded Gjon Luli, prijësi dhe hero i kësaj kryengritjeje hyn kështu në plejadën e prijësve të kombit shqiptar. Ai është një prijës e një hero tipik shqiptar, nga ata që shkojnë në luftë me krejt familjen, dhe që bashkërisht me vëllezër e motra, nipër e mbesa janë të gatshëm për filijim".

27.11.2015. Shtatorja e Ded Gjon Lulit u vendos në qendër të Tiranës, pranë Muzeut Historik Kombëtar. Financuesi i shtatores ka qenë Gjok Uldejad, i cili në ditën e promovimit të shtatores së heroit Ded Gjon Luli, e trajtoi si një simbolikë të rëndësishme për malësorët, për "...një figurë emblematike, flamurtari i parë i Shqipërisë së Madhe, nismëtar të pavarësisë së vendit tonë. Ded Gjon Luli është krenaria e maleve dhe më gjerë. Në kërthizë të Tiranës kushdo mund ta prekë lartësinë e këtij hero i legjendar të historisë së Shqipërisë dhe të shqiptarëve.

Burimet e studimit:

Rritja në përdorimin e pajisjeve celulare i ka bërë gjithashtu mjetet e spiunazhit kibernetik si "Pegasus" më efektive dhe të rrezikshme. Zhvilluar nga Grupi NSO, malware përdor disa shfrytëzime me zero-klikim për të fituar akses në pajisjet e synuara përpara se t'i marrë ato dhe të mbledhë të dhëna nga burime të ndryshme (tekste, telefon, e-mail, etj.). "Pegasus" është zyrtarisht i disponueshëm vetëm për qeveritë, forcat e zbatimit të ligjit, etj., por ka një histori abuzimi për të shënjestruar gazetarët, aktivistët, zyrtarët e qeverisë dhe drejtuesit e biznesit. Frymëzuar nga sukcesi i "Pegasus", Cytrox, një vend i Maqedonisë së Veriut, tani ofron një mjet të ngjashëm të quajtur "Predator", dhe ky kërcënim ka të ngjarë të përhapet edhe tek aktorët e zakonshëm të kërcënimit kibernetik.

Në vitin 2021, kriminelët kibernetikë përshtatën taktikat e tyre për të përfituar nga adoptimi në rritje i celularëve. Janë shfaqur disa celularë malware "Trojan", duke përfshirë malware-in "FlyTrap", "Triada" dhe "MasterFred". Këta celularë "Trojan" përfitojnë nga



mediat sociale, kontrollet e dobëta të sigurisë së dyqaneve të aplikacioneve dhe teknika të ngjashme për të fituar akses dhe lejet e nevojshme në pajisjet e synuara.

Pajisjet celulare janë bërë një front i ri në luftën kundër krimit kibernetik. Për biznesin modern, siguria celulare është një pjesë kyçe e një strategjie të sigurisë kibernetike të korporatës.

Sulmet kibernetike më të fundit

Pas 24 shkurtit, me fillimin e pushtimit rus në Ukrainë, Rusia ka ndërmarrë një sërë sulmesh për shumë shtete aleate të Ukrainës. Një ndër vendet e prekura nga sulmet kibernetike është edhe Shqipëria. Nëpërmjet platformave të monitorimit për sigurinë kibernetike të ngritura për sistemet dhe infrastrukturat qeveritare shqiptare, u vu re një sulm kibernetik kompleks dhe në shkallë të gjerë, ndaj platformës qeveritare e-Albania. Menjëherë, duke ndjekur protokollet e reagimit, u krye izolimi i infrastrukturave dhe sistemeve qeveritare për të garantuar mbrojtjen e të dhënave. Metodot mbi të cilat aktorët keqbërës kanë vepruar janë të ngjashme me sulmet e vitit të fundit, të vëna re në hapësirën kibernetike ndërkombëtare. Teknikat mbi të cilat ky sulm mbështetej ishin të së njëjtës natyrë me ato të përdorura për një sërë sulmesh kibernetike në domain-et qeveritare dhe private të kohëve të fundit, si në Ukrainë, Gjermani, Lituani, Maltë, Holandë, Belgjikë dhe vende të tjera të rajonit". Detektimi dhe përgjigjja e shpejtë ndaj këtyre sulmeve bëri që sistemet qeveritare të dalin të paprekura.

Ndërkaq, në gjithë këtë situatë, në Taipei, Tajvan, më 4 gusht, Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit tha se uebfaqja e saj pësoi sulme kibernetike dhe u shkëput përkohësisht, duke shtuar se po punonte ngushtë me autoritetet e tjera për të rritur sigurinë kibernetike ndërsa tensionet me Kinën rriten. Disa uebsajte qeveritare, përfshirë zyrën presidenciale, iu nënshtruan sulmeve kibernetike nga jashtë shtetit, disa prej të cilave autoritetet thanë se ishin nisur nga Kina dhe Rusia.

Iran, korrik 2022, hakerët shënjestruan Organizatën Islamike të Kulturës dhe Komunikimit të Iranit (ICCO). Sulmi shkatërroi të paktën 6 faqe interneti, vendosi imazhe të liderëve të rezistencës iraniane në pesëmbëdhjetë faqe të tjera, fshiu bazat e të dhënave dhe kompjuterët dhe lejoi hakerët të merrnin akses në të dhënat e ndjeshme të ICCO.

Belgjikë, korrik 2022, Ministria e Jashtme e Belgjikës akuzoi Kinën për një fushatë kibernetike spiunazhi kundër objektivave belge, duke përfshirë Ministrinë e Brendshme dhe të Mbrojtjes të Belgjikës. Një zëdhënës i ambasadës kineze në Belgjikë mohoi akuzat.

Britani, korrik 2022, hakerët synuan llogaritë e mediave sociale në pronësi të Ushtrisë Mbretërore Britanike. Sulmi përfshinte marrjen e llogarive të Ushtrisë Britanike në Twitter dhe YouTube.

Lituani, korrik 2022, hakerët shënjestruan ofruesin shtetëror Lituani për energjinë në një sulm DDoS. "Killnet", të cilin zyrtarët lituanes e lidhin me Rusinë, mori përgjegjësinë për sulmin.

Ukrainë, korrik 2022, hakerët shkelën një kompani mediatike ukrainase për të transmetuar në radio stacione të shumta se presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy ishte në gjendje kritike.

Zelenskyy hodhi poshtë pretendimet dhe fajësoi Rusinë për sulmin.

Kinë, korrik 2022, Kina deklaroi se Shtetet e Bashkuara vdhën 97 miliardë pjesë të të dhënave globale të internetit dhe 124 miliardë pjesë të të dhënave telefonike në qershor, duke fajësuar veçanërisht Zyrën e Operacioneve të Përshtatura të Aksesit (TAO) të Agjencisë Kombëtare të Sigurisë (NSA).

Lituani, qershor 2022, hakerët shënjestruan hekurudhat shtetërore të Lituani, aeroportet, kompanitë e medias dhe ministrinë e qeverisë me sulme DDoS. Një grup hakerësh i mbështetur nga Rusia mori përgjegjësinë për sulmin.

SHBA, qershor 2022, FBI, Agjencia e Sigurisë Kombëtare (NSA) dhe CISA njoftuan se hakerët e sponsorizuar nga shteti kinez synonin dhe shkelnin kompanitë kryesore të telekomunikacionit dhe ofruesit e shërbimeve të rrjetit që të paktën që nga viti 2020.

Izrael, qershor 2022, hakerët shënjestruan ish-zyrtarët izraelitë, personelin ushtarak dhe një ish-ambasador të SHBA-ve në Izrael. Një firmë izraelite e sigurisë kibernetike deklaroi se aktorët të lidhur me Iranin përdorën një fushatë phishing për të fituar akses në kutitë hyrëse të objektivave, informacionin personal të identifikueshëm dhe dokumentet e identitetit.

Iran, qershor 2022, hakerët synuan tre kompani iraniane të çelikut, duke e detyruar fabrikën shtetërore të vendit të ndalojë prodhimin.

Hakerët zbuluan skedarë dhe foto të njohura si "Dosjet e Policisë Xinjiang" që shfaqin abuzimet e të drejtave të njeriut të kryera nga qeveria kineze kundër popullsisë ujgure.

Australi, qershor 2022, një fushatë dezinformuese e lidhur me Kinën synoi kompaninë australiane të minierave "Lynas Rare Earths". Fushata përfshinte përhapjen e dezinformatave në platformat e mediave sociale dhe faqet e internetit në lidhje me të dhënat e pretenduara mjedisore të "Lynas Rare Earths".

Itali, maj 2022, hakerët rusë goditën faqet e internetit italiane me një sulm DDoS, duke përfshirë Senatin, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit. Grupi thotë se qëllimi i tij ishte të synonte vendet e NATO-s dhe Ukrainën.

Rumani, prill 2022, Drejtoria Kombëtare Rumune e Sigurisë Kibernetike tha se uebfaqet të shumta të sektorit publik dhe privat u goditën me sulme DDoS. Viktimat përfshinin ministrinë e mbrojtjes, policinë kufitare, kompaninë kombëtare të hekurudhave dhe OTP Bank. Një grup që pretendon meritën për sulmin tha se ka hakuar faqet e internetit sepse Rumania ka mbështetur Ukrainën që nga pushtimi rus i vendit.

Prill 2022, studiuesit e sigurisë kibernetike identifikuan një fushatë të re nga hakerët e lidhur me Rusinë që filloi në janar dhe synon diplomatë dhe zyrtarë të ambasadave nga Franca, Polonia, Portugalia dhe vende të tjera. Hakimet filluan me një "email phishing" për të dërguar një skedar të ngarkuar me malware në objektiv.

Prill 2022, hakerët shënjestruan anëtarët e Komisionit Evropian me spyware të zhvilluar nga "NSO Group". Një njoftim i "Apple" nga nëntori për mijëra përdorues të "iPhone", duke thënë se ata ishin në shënjestër nga aktori i sponsorizuar nga shteti, paralajmëroi Komisionin për këtë përdorim spyware.

Një platformë e mediave sociale ndërpreu dy fushata spiunazhi kibernetik të lidhura me Iranin që synonin aktivistët, akademikët dhe kompanitë private. Fushata synoi bizneset në sektorët e energjisë, gjysmëpërçuesve dhe telekomunikacionit në vende duke përfshirë SHBA-në, Izraelin, Rusinë dhe Kanadanë duke përdorur phishing dhe teknika të tjera të inxhinierisë sociale.

Sipas studiuesve, një grup synoi disa organizata mediatike ukrainase në një përpjekje për të fituar akses afatgjatë në rrjetet e tyre dhe për të mbledhur informacione të ndjeshme. Grupi ka lidhje me GRU-në ruse.

Hakerët shënjestruan një objekt energjetik të Ukrainës, por CERT-UA dhe ndihma e sektorit privat penguan kryesisht përpjekjet për të mbyllur nënstationet elektrike në Ukrainë. Studiuesit besojnë se sulmi erdhi nga i njëjti grup me lidhje me GRU-në ruse që synoi rrjetin elektrik të Ukrainës në vitin 2016, duke përdorur një formë të përditësuar të të njëjtit malware.

Çfarë po vjen më pas për industrinë e sigurisë kibernetike?

Shpenzimet për sigurinë kibernetike nuk ka gjasa të ngadalësohen së shpejti. Korporata Ndërkombëtare e të Dhënave (IDC) parashikon që shpenzimet e sigurisë kibernetike në mbarë botën do të arrijnë në 174.7 miliardë dollarë në vitin 2024, me shërbimet e sigurisë dhe me rritjen më të shpejtë të tregut.

Rritja e sulmeve kibernetike, veçanërisht ransomware, ka nxitur tregun e sigurimeve kibernetike. "GlobalData", një lider në të dhëna dhe analitikë, parashikoi që industria do të arrijë 8.92 miliardë dollarë në 2021 dhe më shumë se dyfish në 20.6 miliardë dollarë deri në vitin 2025.

KONTRIBUTI SHQIPTAR në panteonin e *vlerave botërore*



Inva Mula

Sopranoja me famë ndërkombëtare, e cila përfaqëson denjësisht vendin tonë në skenat botërore.

Inva Mula, e lindur më 27 qershor 1963, ajo është një soprano lirike shqiptare e operës. Ajo e filloi karrierën e saj si soprano që në moshë shumë të re. Ajo vjen nga një familje artistësh. I ati saj, Avni Mula, është një nga kompozitorët dhe këngëtarët më të talentuar në Shqipëri dhe nëna, Nina Mula, ishte gjithashtu këngëtare e operës. Në vitin 1987 fitoi konkursin "Këngëtarja Shqiptare", më 1988 konkursin "George Enescu" në Bukuresht. Pas katër vjetësh në 1992 fiton konkursin "Butterfly" në Barcelona. Në 1993 merr një çmim në Operalia-n e parë të Placido Domingos në Paris. Ka bashkëpunuar me tenorë të famshëm në operën e Bastille-s në Paris, në Bruksel, në Mynih dhe në Oslo. Në vitin 1996 mori pjesë në operën Medee të Luigi Cherubini-t në Francë. Në 1998 rikthehet në operën e George Bizet "La Jolie fill de Perth". Në filmin "Elementi i pestë" në 1997 i jep zërin këngëtares në rol Lucia di Lammermoor

në skenën The Diva Dance". Më vonë ajo luajti në "Ivan IV" të Bizet-it në Paris. Në vitin 2001 ishte e zënë në Itali ku luajti në teatrin "La Scala" pjesën e Verdit "Falstaff" dhe Riggoletto-n në Arenën e Veronës. Ka marrë pjesë rregullisht në "La Scala", ku luajti Lucia di Lammermoor, La bohème, Manon (2006). Luajti gjithashtu disa herë dhe La traviata-n në qytete të rëndësishme si Tokio, Bilbao, Orange, Trieste dhe Toronto. Në 2007, ajo do të luajë Norine-n e parë në "L'elisir d'amore" në Toulouse të Francës.

Në vitin 2009, Inva Mula publikon albumin "Il Bel Sogno", në vitin 2012, publikon albumin "Per Ty Atdhe".

Tedi Papavrami

I lindur në Tiranë më 1971, ai u lidh me violinën që në moshën katërvjeçare. Studioi violinë me të atin, profesorin e njohur Robert Papavrami, i cili ka ndikuar mjaft në të ardhmen e tij artistike. Në moshën 8-vjeçare, inter-



preton "Arie Bohemienne të Sarasate" me orkestrën Filarmonike të Tiranës dhe tre vjet më vonë Koncertin e parë për violinë të Paganini-t. Ai ishte shume i talentuar dhe i ati besonte shumë te talenti i tij. Ky i fundit ishte i vendosur që Tedi të bëhej dikush në jetë. Në shtator 1982, falë flautistit Alain Marion, qeveria franceze i ofron një bursë studimi në Francë, ku studion pranë "Conservatoire National Supérieur de Musique" në Paris, nën drejtimin e Pierre Amoyal. Në vitin 1985 fiton konkursin "Rodolfo Lipitzner" në Gorizia, në 1986 fiton me unanimitet "Çmimin e parë të Konservatorit të Parisit, në vitin 1987 merr diplomën e Konservatorit të Losanës. Më pas ndjek studimet muzikore nën drejtimin e Zino Francescati e Viktori Mullova. Në vitin 1992 vlerësohet nga Sacem me çmimin "George Enescu" dhe në 1993 fiton çmimin e parë dhe çmimin special të publikut në konkursin ndërkombëtar "Sarasate" në Pamplona.

Tedi krahas karrierës së tij si violinist ka përkthyer veprat e Ismail Kadarese pas vdekjes së Jusuf Vronit në vitin 2002 dhe luan personazhin kryesor në filmin "Kronike provinciale". Ai ka interpretuar në Europë, Afrikën e Jugut, Turqi, Japoni, Izrael, me orkestra të njohura si "Orchestra di Bologna", "Bamberger Symphoniker", etj. Ka interpretuar nën drejtimin e dirigjentëve të njohur si K. Sanderling, C. Hogwood, A. Pappano, L. Langree, G. Varga, Z. Macal, J. C. Casadesus, etj. Në 2000-2001 ka interpretuar me "Orchestre Philharmonique de Nice", "Orquesta Sinfonica de Galicia", "Orchestre Philharmonique de Liege", etj., si dhe ka zhvilluar disa turne në Japoni me "24 capricci" të Paganinit dhe është ndër të paktët violinistë që interpreton integrale. Artisti i gjithanshëm Tedi Papavrami interpreton rregullisht repertorin e muzikës së dhomës së bashku me P. Bianconi, H. Sermet, M. Rubackyte, P. Meyer, E. Lesage, R. Oleg, G. Hoffman, etj.

Saimir Pirgu

I lindur në Elbasan, në vitin 1981, Saimir Pirgu filloi formimin muzikor në moshë shumë të re, duke përfunduar studimet për Violinë në qytetin e tij në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Në moshën njëzet e një vjeçare ai u diplomua në "Conservatorio Claudio Monteverdi" në Bolzano, Itali, ku studioi zërin me Vito Maria Brunetti, i cili mbetet një këshilltar i rëndësishëm i tenorit edhe sot e kësaj dite.

Ishte rastësi që Saimir Pirgu u takua me Luciano Pavarottin kur ishte ende student. Tenori italian e stërviti në shumë nga rolet e tij më të rëndësishme deri në fund të jetës.

Në vitin 2002, tenori i ri fitoi çmimin e parë në konkurset ndërkombëtare të zërit, Caruso dhe Tito Schipa, duke krijuar terrenin për përparimin e tij ndërkombëtar. Claudio Abbado zgjodhi më pas këngëtarin njëzet e dy vjeçar për rolin e Ferrandos në "Così fan tutti" në Ferrara, i njëjti rol me të cilin në vitin



2004, nën drejtimin muzikor të Philippe Jordan, z. Pirgu do të bëhej këngëtar më i ri ndonjëherë në debutimin në një rol kryesor në Festivalin e Salzburgut.

Menjëherë pas debutimit të Saimir Pirgut në Festivalin e Salzburgut nisi një bashkëpunim i rëndësishëm me Operën Shtetërore të Vjenës, ku përveç shumë roleve të tjera Pirgu interpretoi "Nemorino" në "L'elisir d'amore", për të cilin u vlerësua me çmimin "Eberhard Wächter Gesangsmedaille", i cili dhurohet çdo vit për një këngëtar të ri premtues.

Në vitin 2008 ai u zgjodh nga Woody Allen për vënien e parë të operës së regjisorit të filmit, duke interpretuar rolin e Rinuccio në "Gianni Schicchi" në Operën e Los Anxhelosit. Pas kthimit të tij në "Opera Metropolitan" gjatë vitit 2013 si Alfredo në "La traviata", "New York Times" i kushtoi një artikull dy faqesh me titullin "Tenori nga ana e errët e hënës". Në vitin 2009 Saimir Pirgu u nderua me çmimin "Franco Corelli" të "Teatro delle Muse" të Ankonës për interpretimin e tij në "La traviata" dhe në vitin 2013 iu dha çmimi prestigjioz "Pavarotti d'Oro".

Në vitin 2016, albumi i tij më i fundit solo "Il Mio Canto" u publikua në labelin "Opus Arte". Ai e prezantoi CD-në në një turne botëror që e çoi në Paris, Vjenë, Berlin, Tokio, Nju Jork, Firence dhe Tiranë.

Saimir Pirgu figuron ndër yjet më të shndritshëm në qiellin e sotëm ndërkombëtar të operës. "Jashtëzakonisht djaloshtar, butësisht i zjarrtë dhe i qetë në fluturimet stratosferike" - (Financial Times); "Tenori me zë të ëmbël, energjik" - (New York Times) është festuar në çdo vend të madh operistik ndërkombëtar.

Saimir Pirgu është ambasador i "Down Syndrome Albania", një fondacioni i përkushtuar për të ndihmuar fëmijët me sindromën Down, që nga viti 2013.



Rita Ora

Rita Ora (Rita Sahatçiu Ora), lindur më 26 nëntor 1990, është një këngëtare dhe autore këngësh britanike. Ajo u bë e njohur në shkurt 2012, kur u shfaq në këngën e DJ Fresh, "Hot Right Now", e cila arriti numrin një në MB. Albumi i saj debutues në studio, Ora, i lëshuar në gusht 2012, debutoi në numrin një në Mbretërinë e Bashkuar. Albumi përmbante këngët më të dëgjuara në Mbretërinë e Bashkuar, "R.I.P." dhe "How We Do (Party)". Ora ishte artistja me numrin më të madh të këngëve në listën e këngëve në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2012, me tre këngë që arritën pozicionin e parë.

E lindur në Prishtinë, Kosova e sotme, Ora u emërua "Ambasadore Nderi e Kosovës" në vitin 2015. Albumi i dytë në studio i Orës, "Phoenix", u publikua në nëntor 2018. Kënga kryesore, "Your Song", arriti në dhjetëshen më të mirë të Mbretërisë së Bashkuar dhe këngët e mëvonshme, "Anywhere" dhe "Let You Love Me", arritën në pesëshen e parë në MB. "Let You Love Me" e bëri Orën artisten e parë femër britanike solo që ka trembëdhjetë këngët më të mira në Mbretërinë e Bashkuar.

Dua Lipa

Një tjetër yll i muzikës me origjinë shqiptare. Prindërit e saj u zhvendosën për në Angli në vitet '90, ndaj Dua lindi në Londër, më 22 gusht 1995, nga nëna e saj, Anesa Lipa dhe babai, Dukagjin Lipa. Ajo është e para nga tre fëmijët.

Që në fëmijëri, artistes i pëlqente të rrinte pranë babait të saj. Në atë kohë, ajo do të dëgjonte në heshtje tingujt e kitarës së tij ndërsa ai ushtronte për shfaqjen e tij të radhës. Ai ishte gjithashtu një yll roku, me sa duket jeta muzikore e të cilit ndikoi në ambicijen e Lipës.

Falë vendosmërisë së saj për të hyrë në

botën e spektaklit, ajo filloi të këndonte në moshën e hershme 5-vjeçare.

Në shkollën fillore të Fitzjohn studioi shumë dhe mori mësimë muzike, konkretisht në Violonçel.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, familja e artistes u transferua përsëri në Prishtinë në vitin 2008. Atje Lipa mësoi më shumë për prejardhjen e saj dhe gjuhën shqipe.

Dy vjet pasi familja e saj u transferua në Prishtinë, Dua diskutoi për të ardhmen e saj me babanë dhe nënën e saj. Ajo i informoi ata se si dëshiron të ndjekë një karrierë me kohë të plotë në muzikë. Lipa 15-vjeçare u kthye në Londër në 2010.

Si një plan themelor i pushtimit të botës së spektaklit, Dua ndoqi Akademinë e Parlamentit (për nivelet e saj A) dhe Shkollën e Teatrit "Sylvia Young". Gjatë kësaj kohe, ajo filloi të ngarkonte këngët e saj në YouTube dhe SoundCloud.

Ajo shpejt fitoi pak popullaritet dhe filloi modelimin me Topshop. Ajo fitoi rolin e një këngëtareje në një reklamë për "The X Factor" në 2013.

Në një kohë jo të largët, Lipa, për fat të mirë, takoi Mawson me të cilin bashkë-shkruan këngën "Hotter than Hell".

Në vitin 2014, ajo filloi të fitojë njohjen që meriton pasi nënshkroi një kontratë me "Warner Bros Records".

Përparimi i saj më i madh erdhi pasi ajo publikoi këngën e saj të parë - "New love", madje fitoi vlerësimet e saj pozitive dhe krahasim me Lady Gaga-n.

Lipa filloi të thyente shumë rekorde, duke prodhuar albume që u bënë virale dhe arritën kulmin në platforma të famshme si "Billboard Hot 100". Talenti i saj në muzikë ka fituar 81 çmime (përfshirë 3 Grammy) dhe 238 nominime që nga viti 2021.

Ajo ka pasur bashkëpunime tepër të suksesshme me shumë artistë ndërkombëtarë, ku përfshihen Sean Paul dhe Calvin Harris.





Arkitektura SHQIPTARE në shekuj

Trashëgimi natyror është tërësia e vlerave të mjedisit fizik dhe jetësor të trashëguar brez pas brezi.

Vlera materiale, vlerat jo materiale - historike, gjuha, vallet arkitekturore, zakonet, këngët, arkeologjike, traditat, letërsia fetare - artistike.

Monumente historike

Në territorin e Shqipërisë gjenden një varg kështjellash të cilat datojnë që prej periudhave antike e deri në mesjetë. E veçanta është se disa prej tyre vazhdojnë të banohen edhe në ditët tona. Disa nga kalatë më të njohura janë: kalaja e Krujës, kalaja e Elbasanit, kalaja e Beratit, kalaja e Shkodrës, kalaja e Tepelenës, kalaja e Tiranës, monumenti i Ali Pashë Tepelenës i cili është prej bronzi, me peshë 4 ton. Ai është vendosur në qytetin e Tepelenës.

Monumente arkitekturore: Tempulli "Ngjallja e Krishtit", Amfiteatri i Butrintit, i Bylisit, i Durrësit, i Apolonisë etj.

Pazari i Krujës, Varri i Kapllan Pashës, Banesa e Shijakasve, Ura e Tabakëve, e Beratit, Mesjetare (Elbasan) etj.



Monumente arkeologjike

Territori i Shqipërisë njihet si një nga vendet me numër të lartë zonash arkeologjike që dëshmojnë qytetërimin e lashtë ilir. Të tilla janë qyteti: Durrësit, Vlorës, Sarandës, Elbasanit, Beratit, Gjirokastrës, Tiranës, Tepelenës, Shkodrës.

Monumente fetare

Manastiri i Mesopotamit (Sarandë), Xhamia Mbret (Berat), Xhamia e Hysen Pashës (Berat), Xhamia e Ethem Beut (Tiranë), Teqeja e Dollmës (Krujë), Teqeja e Zallit (Gjirokastrë), Tyrbja e Kapllan Pashës (Tiranë), Kulla e Dervish Aliut (Vlorë), Katedralja Fjetja e Shën Mërisë (Berat), Kisha e Shën Premtes (Kavajë), Kisha e Grabovës (Gramsh), Kisha e Shën Sotirit (Përmet), Faltorja (Shkodër)

Mozaiku i Tiranës. Mozaiku i Orfeut (Durrës), Skulptura e Skënderbeut, Skulptura "I Urituri" (Odise Paskali), Monumenti i Pavarësisë.

Monumente mjedisore

Monumentet mjedisore përbëjnë vlera të trashëgimisë kombëtare, duke u radhitur në kategorinë e tretë të zonave të mbrojtura. Ato gëzojnë mbrojtjen e kategorisë së parë. Të tilla monumente janë: Kanioni i Osumit, Liqeni i luleve, Shpella e piratëve, Burimi i syrit të kaltër, Shkëmbi i Kavajës, Liqeni i Degës - Liqeni i Ohrit, Hinka e Kosovës, Shpella e Kabashit.

Në kulturën e shqiptarëve ka lënë gjurmën e saj të thellë historia e tyre e brendshme dhe e jashtme. Gjatë sundimit osman jeta kulturore u fashit, monumentet e kulturës materiale e shpirtërore u zhdukën nën rrënojat e shkatërrimit të luftërave; gjysmëhëna e uli kryqin dhe gati dy të tretat e popullatës në fund të shek. XVII ishin konvertuar në fenë islame. Qëndresa në fushën e kulturës u shpreh në radhë të parë përmes lëvrimin të shqipes nëpërmjet botimeve të teksteve fetare. Reforma protestante gjallëroi shpresat e zhvillimit të gjuhës e të traditës letrare vendëse kur prifti Gj. Buzuku në 1555 shkroi veprën e parë në shqip "Meshari".

Qyteti mesjetar

Qytete që lidhen me fortifikimet, si Berati, Gjirokastra etj., të cilët shtrihen në terrene të rrafshët ose të pjerrët si Tirana, Kavaja, Elbasani.

Qytetet me kështjella janë dhe qytetet më të lashta, por dhe më të zhvilluarit. Fillimisht, qyteti është i lidhur me fortifikimin, por më vonë me lindjen e varosheve, qyteti shtrihet jashtë fortifikimit. Terrenet e thyer janë dhe mbrojtje natyrale. Terreni i pjerrët ka ndikuar mjaft në krijimin e ansambleve arkitektonike me orientim të detyruar, ku të gjitha ndërtimet i vishen faqes së kodrës, duke krijuar ndërtime organike dhe kompakte. Ngushtica

e truallit përbën një problem në këtë rast. Ndërtimet vendosen në formë vargu si në lagjen Mangalem të Beratit ose kanë shtrirje më të lirë si në disa lagje të Gjirokastrës. Lidhja me terrenin, rrit monumentalitetin e këtyre ansambleve. Banesa del drejtpërdrejt në rrugë, duke marrë pjesë aktivisht në formimin e saj. Terreni ka kushtëzuar ndërtimin e banesës 2-3 kat, e cila për vetë kompozimin vertikal dhe vendosjen në formë shkallësh, është elementi kryesor mbisundues në krejt formulimin arkitektonik. Ndërtimet e kultit humbasin në këto ansamble, duke u shkrirë me masën dinamike të ansambllit të banesave në formë shkalle që është edhe elementi më i qenësishëm arkitektonik i këtij kompozicioni.

Një karakter tjetër kanë qendrat qytetare apo lagjet në terren të rrafshët. Ndërtimet janë të rralla, me troje të mëdha dhe të rrethuar me mure të lartë. Banesa shumë rrallë merr pjesë në formulimin e rrugës. Gjelbërimi i dendur shpesh mbulon banesën. Qetësia kompozicionale këtu thyhet vetëm nga ndërtimet e kultit mysliman. Ato zakonisht ndërtohen në sheshe, duke bërë më të përcaktueshme efektin e volumeve të tyre dinamike. Në qytetin mesjetar shtresat e pasura nga ato të varfra dalloheshin nga banesa. Banesat e të pasurve ndërtoheshin në troje të përshtatshme, të gjera, plot dritë e gjelbërim, kurse shtëpitë e të varfërve



në troje të ngushta dhe pa shumë dritë. Dasitë fetare janë pasqyruar gjithashtu në qytetin shqiptar mesjetar.

Në qytetet me mure mbrojtës, rrugët kryesore zënë fill nga hyrjet e kalasë duke u shpërndarë pastaj në një mori rrugësh dytësore që ndiqnin në përgjithësi vijat e izohipsave. Por lindte nevoja dhe e rrugëve pingule me to, të cilat realizoheshin në formën e shkallëve. Një vend të rëndësishëm luajnë dhe rrugët që lidhin qendrën tregtare me zonat e banimit si dhe rrugët midis lagjeve. Në qytetet e rrafshëta, rrugët kryesore janë vazhdim i atyre që lidhin qytetin me qytetet e tjera. Në vend të rrugëve të ngushta të qyteteve shkëmbore, në qytetin

e rrafshët rrugët janë më të gjera, por shpesh pa krye, të cilat shtrohen me kalldrëm.

Gjelbërimi është karakteristikë tjetër e qytetit të asaj kohe. Veçanërisht në lagjet me terren të thyer, gjelbërimi bën lidhjen e ndërtimeve me trojet në mënyrë të natyrshme, duke theksuar karakterin monumental të saj.

Në gjendjen e sotme, qytetet-muze të Beratit, Gjirokastrës, (të dy këto qytete mbrohen nga UNESCO) si edhe qendrat historike të Elbasanit dhe Korçës, i përgjigjen në kompozim urbanistik arritjeve të shek. 18-19.

Në arkitekturën e ndërtimeve qytetare një vend të rëndësishëm zë banesa, për vetë përhapjen e gjerë dhe vlerën e realizimeve arkitektonike në të gjitha trevat e Ballkanit të banuar nga shqiptarët. Banesa pati lulëzimin e saj gjatë shek. 18-19, ku ajo dallohet për një tipologji të pasur dhe të kristalizuar, si dhe për arritje me vlera të mëdha si në fshat dhe në qytet. Lëvizja e madhe e rilindjes kombëtare që përkon me lindjen e marrëdhënieve kapitaliste, u pasqyrua në pasurinë e madhe të vlerave arkitektonike të banesës. Banesa qytetare dallohet në tipologji nga banesa fshatare, sidomos nga ajo e Shqipërisë së veriut. Banesa qytetare në shumicën e rasteve është banesë një familjare, por rrallë hasim dhe banesa për dy vëllezër që zhvillohen në simetri sipas një aksi.

Banesa qytetare gjatë shekujve XVI-XIX

Sipas kompozimit planimetriko-volumor, banesa qytetare klasifikohet në 4 grupe:

Banesa shqiptare me shtëpi me:

- vatër zjarri (banesa tiranase)
- Banesa me hajat
- Banesa me çardak
- Kulla qytetare (banesa gjirokastrite)

Urbanistika dhe Arkitektura e qyteteve shqiptare në gjysmën e parë të shek. XX

Kjo periudhë përkon me pushtimin austro-hungarez, mbas saj me periudhën e qeverisë së Fan Nolit, vazhdon me mbretërinë e Zogut, dhe, në fund me pushtimin Italian. Qytetet shqiptare me fizionomi mesjetare fillojnë t'i nënshtrohen studimeve të mirëfillta urbanistike të realizuara nga arkitektë austro-hungareze, të cilat tentonin t'i jepnin qyteteve shqiptare pamjen e qyteteve europiane.

Më 1920 Tirana shpallet kryeqytet i Shqipërisë dhe qeveria e Fan Nolit vendos t'i japë qytetit pamjen dinjitoze të një kryeqyteti European, i cili duhet të ishte njëkohësisht dhe qendër administrative. Për këtë arsye projektohet për herë të parë sheshi në qendër të qytetit (sheshi Skënderbej), ku u hodhën njollat e para të godinave qeveritare, si dhe aksi historik Veri-Jug i bulevardit të madh, në të cilin bën pjesë ky shesh,



dhe që ka autor inxhinier Eshref Frashërin, ministër në qeverinë e Fan Nolit, së bashku me dy autorë të tjerë; njëri italian Chiaravelli dhe tjetri austriak Weiss.

Mbreti Zog i dha një rëndësi të madhe planeve rregulluese të qyteteve kryesore të vendit, një pjesë e të cilave gjeti zbatim. Më 1930, në Tiranë fillon zbatimi i bulevardit të madh, i quajtur bulevardi "Mbreti Zog", dhe ndërtimi i ministrive. Gjithashtu zgjerohen rrugët kryesore të qytetit dhe përcaktohet kufiri i qytetit. Më 1931, kufiri i kryeqytetit brenda përshkruante një sipërfaqe prej 600 hektarësh dhe përcaktoheshin zonat e zhvillimit në perspektivë, si p.sh. zona industriale, e banimit, e gjelbëruar etj. Në këtë periudhë autorët e planeve rregulluese janë arkitektët austriakë, ku veçojmë arkitektin Kohler.

Në periudhën e pushtimit nga Italia fashiste, pas 1939, arkitektët italianë rishikojnë të gjitha planet rregulluese të qyteteve kryesore ose i bëjnë nga fillimi. Arkitektura dhe Urbanistika në këtë periudhë është racionale, pra e tipit fashist. Dallohet kompleksi i "sëpatës së liktorit" në fund të bulevardit kryesor të Tiranës i përbërë nga Stadiumi, zyrat e Fashos (tani UT) dhe dy godinat anash bulevardit. Arkitektët italianë, ku veçohet arkitekti Gerardo Bosio, Ivo Lambertini dhe Ferdinando Poggi, kanë realizuar hartimin e planeve rregulluese të Tiranës, Durrësit, Vlorës, Elbasanit, Beratit, Petrelës, Sarandës etj., në të cilat përveç arkitekturës dhe urbanistikës racionale, respektohet psikologjia dhe tradita e shqiptarit të lidhur me pronën private etj.

Ato e projektuan Tiranën sipas karakterit ekstensiv me vila private, duke ruajtur zonat historike në qendër me xhaminë, teqenë, Kullën e Sahatit, të cilat merren si pika referimi. Planet rregulluese të qyteteve shqiptare të vitit 1942 të realizuara nga arkitektët italianë janë marrë për bazë në linjat e tyre kryesore në planet rregulluese mbas Çlirimit.

"Piramida" e ndërtuar si muzeum për diktatorin Enver Hoxha dhe e konvertuar me 1992 në Qendër ndërkombëtare të Kulturës të asaj Kulture që ai, Enver Hoxha, ia privoi shqiptarëve për 50 vjet të qeverisjes së tij drakoniane.

“KUR ITALIA ishte “Amerika” për shqiptarët”

“Kur Italia ishte “Amerika” për shqiptarët”, titujt e para 31 viteve të mediave italiane, të cilat do pasqyrojnë gati të traumatizuar gjithçka po ndodhte në vendin e tyre nga fluksi i emigrantëve, ishte gati i pa menaxhueshëm.

Më 8 gusht 1991, anija shqiptare e mallrave “Vlora”, mbërriti në portin e Barit, e tejmbushur me refugjatë nga Shqipëria.

Anija Vlora mbërrin nga Durrësi, pothuajse ka mbaruar karburantin, përpiket të ankorohet në Brindisi por leja i refuzohet.

Anija shkon drejt Barit. Në anije ka edhe njerëz të armatosur, përveç emigrantëve në arrati nga regjimi 45-vjeçar komunist, tashmë i mbaruar. Në bord ka dhe shumë nëna me fëmijë.

Komandanti i anijes Halim Milaqui tregon që anija e tij kishte ardhur nga Kuba, me sheqer, dhe nuk kishte përfunduar ende shkarkimi, kur u afrua një lumë me njerëz.

Atëherë ai dha urdhër që anija të nisët, por disa persona kishin arritur të hipnin në anije dhe me armë në dorë e kërcënojnë të kthehet pas dhe të marrë të gjithë njerëzit. Të gjithë sa ishin, brenda në anije.

Gazetat italiane të datës 9 gusht 1991 flasin për 11 mijë shqiptarë, por në lajmet e darkës jepet shifra prej 20 mijë shqiptarësh. Por e vetmja gjë e sigurt është lumi i jashtëzakonshëm i shqiptarëve.

Emigrantët fillojnë të kërkojnë

ujë e bukë. Policia i drejton drejt stadiumit të vjetër të Barit.

Kryeministri Giulio Andreotti, deklaroi se:

“Nuk jemi në gjendje të presim shqiptarët që mbërrin në brigjet tona dhe qeveria e Tiranës është dakord me ne që emigrantët të riatdhesohen”.

Në stadium nis lufta. Më të rinjtë fillojnë t'i gjuajnë policisë. Përplasjet zgjatën për tre ditë, mbi 40 policë të plagosur dhe disa qindra të tjerë të plagosur mes emigrantëve. Ushqimet hidhen nga ajri me helikoptera. Skena të një bote tjetër.

Më 8 gusht 1991, anija shqiptare e mallrave “Vlora”, mbërriti në portin e Barit, e tejmbushur me refugjatë nga Shqipëria.

Por ngjarjet kanë pasur një rrjedhë të ndryshme: emigrantët fillimisht u mbyllën në stadiumin e vjetër “Della Vittoria”, dhe më pas u riatdhesuan për në Shqipëri.

Duke ndjekur kronikat e asaj kohe, sot 31 vite më pas, edhe pse si një ëndërr e keqe, kjo pjesë e historisë shqiptare, i duhet treguar brezave se sa shumë ky vend e ka dashur lirinë dhe Europën si destinacionin e vetëm të të ndjerit njeri i vlerë. U ishte vrarë shpresa, ikën nga një regjim që po binte, por me shumë vështirësi dhe në një skamje e mjerim të frikshëm. Dhe kjo me kosto jo të vogël...

Joshja ndaj Italisë erdhi edhe si rezultat i informacioneve të gabuara që qarkullonin në opin-

ionin shqiptar, lidhur me “legjitimitetin” që fitonin emigrantët që mbërrinin në Itali, duke u bazuar në ligjin “Martelli”. Ai ligj ishte shpallur që në janar të vitit 1990, si një përpjekje për të kontrolluar dhe monitoruar emigracionin drejt Italisë në përgjithësi dhe njëkohësisht shërbente edhe për vendosjen e sistemit të kuotave. Sipas ligjit “Martelli”, çdo emigranti, i ligjshëm ose jo, që mund të provonte se kishte hyrë në Itali përpara fundit të vitit 1989, i jepet një leje qëndrimi dyvjeçare. Por në fakt, në korrik 1990, kur mbi 4 000 shqiptarë kërkuan strehë në Itali, ligji “Martelli” u pezullua, dhe vetëm 800 prej tyre u akomoduan.

Pas zgjedhjeve të para demokratike, që u mbajtën në Shqipëri në mars 1991, Shqipëria nuk konsiderohej më si një vend totalitar, por ndërkohë rreth 25 000 emigrantë shqiptarë mbërritën në Itali brenda pak ditësh. Në ato kushte, u ndërpre sërish zbatimi i ligjit “Martelli”, ndërsa në prill të atij viti u krijua Ministria për Komunitetet Italiane jashtë vendit dhe për Emigracionin, në krye të së cilës u vendos socialistja Margherita Boniver. Më 11 maj, Ministria mori mandatin të posaçëm, që shqiptarët e mbërritur në mars t'i shpërdante në të gjithë Italinë, duke i pajisur me leje pune.

Më 20 korrik përfundonte mandati i jashtëzakonshëm i ndihmës për emigrantët. Për shqiptarët u la një hapësirë kohe deri



më 31 korrik, për t'u regjistruar sipas normave të ligjit "Martelli". Ndërkohë, brenda 31 korrikut, qytetarët shqiptarë që donin të ktheheshin në atdhe, duke përfituar nga ndërhyrjet e organizatave të emigracionit, duhej të paraqisnin një kërkesë autoriteteve të sigurimit publik.

Nga 22 mijë shqiptarë që ndodheshin në Itali, të shpërndarë pothuajse në të gjitha rajonet, vetëm 4 mijë kishin gjetur punë, edhe pse sezonale. Më pak se 11 mijë u regjistruan për punë, 2 mijë për kurse për formim profesional dhe 645 u njohën si refugjatë politikë. 1 900 fëmijë të pashoqëruar nga prindër iu besuan gjykatave për të miturit.

Më 23 prill 1991, mbërriti në Romë Aleks Luarasi, sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrisë. Objektivi kryesor i vizitës së tij ishte interesimi pranë autoriteteve italiane për gjendjen reale dhe fatin e emigrantëve shqiptarë në Itali.

Më 25 prill u takuam me Drejtorin e Përgjithshëm të MPJ-së për emigracionin, Colomia, si dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve civile, Delati. Ata na dhanë një pasqyrë zyrtare mbi numrin dhe shpërndarjen e emigrantëve në Itali dhe të të larguarve në vende të tjera të Europës. Në mënyrë të veçantë u trajtua problemi i minorenëve, mundësitë dhe rrugët për kthimin e tyre në atdhe, nevoja e kthimit vullnetar të emigrantëve, si dhe e bashkimit familjar të atyre që ishin shpërndarë në vende

të ndryshme.

Më pas, na priti në një takim edhe Kryeministri Giulio Andreotti, i cili na njohu me përpjekjet e Italisë për të sistemuar emigrantët shqiptarë, por edhe me vështirësitë e mëdha me të cilat po përballeshin. Ai kërkoi një bashkëpunim më të madh midis autoriteteve të të dy vendeve, për ta frenuar këtë dukuri, duke u përqendruar kryesisht në masat parandaluese në territorin shqiptar.

Vizita e Luarasit dhe takimet në Romë u pasqyruan edhe në një komunikatë zyrtare të Ministrisë së Jashtme Italiane. Më 24 prill, nga Roma, së bashku me Luarasin u nisëm në Bari dhe Brindisi ku u njohëm nga afër me gjendjen dhe sistemimin e emigrantëve shqiptarë.

Nga ana tjetër, për të shpjeguar qëndrimet e qeverisë italiane dhe masat për vënien e tyre në zbatim, ministrja Margherita Boniver-i ndërmoi një udhëtim në Tiranë, ku u takua me autoritetet më të larta, duke kërkuar si mirëkuptimin e qeverisë shqiptare, ashtu edhe sensibilizimin e opinionit në vend.

Sipas programeve të qeverisë italiane, filluan të bëhen përpjekje për kthimin gradual në Shqipëri të një pjese të emigrantëve. Ministrja e Emigracionit, Margherita Boniver, i parashtrori qeverisë italiane dhe asaj shqiptare një sërë projektesh për realizimin e planeve. Ideja ishte që

çdo emigranti, që do të pranonte të kthehej vullnetarisht në Shqipëri, do t'i ofrohej mbështetje financiare për të filluar një aktivitet ekonomik privat. Por, pavarësisht marrëveshjes midis dy qeverive, që justifikonte ligjërisht riatdhesimin e 7 000 shqiptarëve, që mbërritën në mars 1991, mënyra e kryerjes së operacionit kishte problematikat saj. Ajo ishte një masë artificiale, që nuk funksionoi asnjëherë.

Në ditët e eksodit të shqiptarëve drejt Italisë, një barrë e rëndë i ra edhe Ambasadës sonë, për të përballuar situatën e krijuar. Kontaktet me autoritetet italiane u shpeshtuan, po ashtu edhe me emigrantët, të cilët herë pas here krahas entuziazmit të mbërritjes në "tokën e ëndërruar", përballeshin edhe me zhgënjimet ndaj realitetit italian. Midis tyre nuk mungonin edhe të njohurit tanë, miq, shokë e të afërm. Ata mendonin se do të gjenin çdo gjë të shtruar, ndaj vështirësitë e para që hasnin bëheshin shkak për nervozizëm. Atyre u dukej se nuk po kryhej siç duhej detyra kundrejt tyre, madje mendonin se po u bëheshin edhe padrejtësi. Ata ishin nën ndikimin e një psikoze kolektive: me të mbërritur në Itali do të gjenin çdo gjë gati. Vragat e dhimbjeve që në shekuj "kurbeti" ka lënë tek shqiptarët nuk janë risi por një e shkuar dhe e tashme e hidhur.



LUIZA GEGA

Kampione e Europës

